



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KUVENDI I KOMUNËS**

Bazuar në nenin 5 shkronja f), nenin 11 ndërlidhur me nenin 12 paragrafët 1 dhe 2 shkronja d), dhe nenet 17 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, nenin 3 paragrafi 1.6, nenet 14, ndërlidhur me nenin 15 paragrafi 2.4, dhe nenet 17 dhe 34 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 janar 2025, merr këtë,

## **V E N D I M**

### **Neni 1**

Me këtë vendim, miratohet Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban i Komunës së Podujevës, për periudhën 2025 – 2029.

### **Neni 2**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban 2025-2029 i Komunës së Podujevës.

### **Neni 3**

Zbatimin e këtij vendimi, respektivisht Planit sipas këtij vendimi e bën Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Drejtoritë dhe sektorët tjerë përkatës të Komunës së Podujevës varësisht fushëveprimatrisë së tyre.

### **Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren 06/2021 si dhe Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave.

Nr.Prot. 01-016/01-0006466/25  
Podujevë, datë: 29 janar 2025



Kryesuesi i Kuvendit  
Hilmi Hoxha



Komuna e Podujevës



PLANI I MOBILITETIT  
TË QËNDRUESHËM URBAN  
KOMUNA E PODUJEVËS  
2025-2029



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



Mbështetur nga:

- Drejtoria e Shpërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit
- Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
  
- Bartës i hartimit të dokumentit: Komuna e Podujevës
- Miratuar në Kuvendin e Komunës

### **Lista e kontribuesve:**

Nxënësit e shkollës IAAP "Fan S. Noli" drejtimi: Transport dhe trafik rrugor  
Qendra e rigjistrimit të automjeteve Podujevë  
QKMF Podujevë  
Stacioni policor Podujevë

Bazuar në nenet 13 dhe 58, shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të statutit të komunes nr. 01-020/01-0050862 kryetari i komunës prof. Dr. Shpejtim Bulliqi me datë 26.08.2024 nxjerrë vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e draft planit të mobilitetit për periudhen 2025-2029, në komunën e Podujevës me këtë përbërje:

Msc. Fatmir Emini	kryesues
Msc. Bujar Blaku	anëtar
Msc. Nexhat Kastrati	anëtar
Mirlinda Zulfaj, zyrtare për transp.	anëtare
Mirlinda Arifi, zyrtare ligjore	anëtare

## Përmbajtja

HYRJE .....	5
Qëllimet dhe objektivat e PMQU .....	7
Fushëveprimi i PMQU.....	8
KORNIZA LIGJORE .....	12
METODOLOGJIA E PUNËS.....	19
2.ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE .....	22
2.1. Profili i komunës së Podujevës për nga perspektiva e mobilitetit .....	22
2.2. Shkalla e motorizimit.....	24
2.3. Pozita gjeografike .....	25
2.4. Rrjeti rrugor në Komunën e Podujevës .....	26
2.4.1. Autorruga .....	28
2.4.2. Rrugët nacionale dhe rajonale .....	29
2.4.3. Rrugët Rajonale .....	30
2.4.4. Rrugët lokale (urbane) .....	31
2.5. Gjendja e udhëkryqeve .....	33
2.6. Transporti publik.....	35
2.7. Parkingjet.....	36
2.8. Rrjeti hekurudhor.....	38
2.9. Siguria në trafik .....	40
2.10.Ngarkesa e trafikut.....	41
2.11. Analiza e ngarkesës së kryqëzimeve .....	44
3. PROPOZIMI I KONCEPTIT/ ZHVILLIMI I KORNIZES .....	52
3.1. Objektivat afatshkurtëra dhe afatgjata – Objektivat SMART.....	52
3.1.1. Strategjia e propozuar – Rrjeti i transportit ndërurban .....	53
3.1.2. Sistemi i transportit publik urban.....	53
3.1.2.1. Strategjia e propozuar – Rrjeti i ri transportit publik urban.....	56
3.1.2.2. Transporti publik dhe shërbimet e taksive-lokacionet.....	57
3.1.3. Koncepti për qendrën e qyteti .....	57
3.1.4. Infrastruktura rrugore dhe menaxhimi i trafikut.....	58
3.1.4.1. Përmirësimi i kapaciteteve të udhëkryqeve dhe masat e sigurisë.....	60
3.1.4.2. Masat e sigurisë ne lokacionet në afërsi te shkollave .....	62
3.1.4.3. Përmirësimi i logjistikës së trafikut në qytet .....	65

3.1.4.4. Trafiku tranzit, bypass-i lokal dhe kushtet e rrugës .....	66
3.1.5. Lëvizjet aktive .....	67
3.1.5.1. Strategjia e propozuar për ecje dhe çiklizëm- koncepti strategjik .....	68
3.1.5.2. Promovimi i përfitimeve shëndetësore nga ecja dhe çiklizmi.....	70
3.1.5.3. Hapësirat për parkimin e biçikletave.....	73
3.1.5. 4. Mbrojtja e ambientit .....	75
3.1.5.5. Përmirësimi i planifikimit të qëndrueshëm urban .....	75
3.1.5.6. Ngritja e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e mjedisit dhe promovimi i transportit të qëndrueshëm .....	75
3.1.6. Menaxhimi i parkingjeve .....	76
3.1.6.1..... Strategjia e propozuar për menaxhimin e parkingjeve në Podujevë .....	76
3.1.6.2. Zhvillimi i politikës së parkimit për qytetin e Podujevës .....	76
3.1.6.3. Menaxhimi i parkingjeve dhe zbatimi i Ligjit .....	77
3.1.7. Siguria në trafik .....	77
3.1.7.1. Strategjia e propozuar për sigurinë e trafikut .....	77
3.1.7.2..... Planifiki mi dhe ndërtimi i terminalit multimodal.....	77
3.1.7.3..... Sigurimi i vendkalimeve rrugë-hekurudhë .....	78
4.1. Përmbledhje e masave dhe plani i implementimit.....	81
4.1.2. Përmbledhje e masave për transportin publik urban.....	81
4.1.3. Përmbledhje e masave për infrastrukturën rrugore.....	83
4.1.4. Përmbledhje e masave për lëvizjet aktive.....	84
4.1.5. Përmbledhje e masave për mbrojtjen e mjedisit.....	86
4.1.6. Përmbledhje e masave për menaxhimin e parkingjeve.....	87
4.1.7. Përmbledhje e masave për sigurinë në trafik.....	90
4.1.8. Përmbledhje e masave për transportin hekurudhor.....	91
5.0. Paramasa dhe parallogaria.....	94

## **HYRJE**

Në këtë hyrje, do të përqendrohemi në objektivat kryesore të planit, përfitimet e tij për qytetarët dhe rolin kyç të teknologjisë dhe inovacionit në transformimin e mobilitetit urban.

Plani i mobilitetit urban është një dokument strategjik që synon të përmirësojë sistemin e transportit në qytet, duke ofruar zgjidhje të qëndrueshme dhe efikase për lëvizjen e njerëzve dhe mallrave. Ky plan përqendrohet në krijimin e një sistemi transporti të integruar, të sigurt, të gjelbër dhe të aksesueshëm për të gjithë, duke marrë parasysh zhvillimin ekonomik dhe mbrojtjen e mjedisit.

Mobiliteti urban është një aspekt kyç për përmirësimin e cilësisë së jetës në qytetet moderne. Me rritjen e popullsisë dhe intensifikimin e urbanizimit, sfidat për lëvizjen janë bërë më të theksuara, duke përfshirë trafikun e rënduar, ndotjen e ajrit, mungesën e hapësirave për këmbësorë dhe çiklistë, si dhe aksesin e kufizuar në transportin publik.

Plani synon të adresojë këto sfida përmes një qasjeje të integruar dhe afatgjatë, duke promovuar përdorimin e transportit publik, krijimin e infrastrukturës për lëvizje të qëndrueshme (si biçikleta dhe këmbësorët), si dhe përmirësimin e kushteve për përdoruesit e automjeteve private.

Mobiliteti i qëndrueshëm urban është një sferë e re e veprimit të pushtetit lokal në Republikën e Kosovës, edhe pse kjo është praktikë në Bashkimin Evropian. Deri më tani, shumë qytete evropiane kanë zbatuar plane të këtilla urbane dhe kanë ndërmarrë një sërë aktivitete në këtë drejtim. Komisioni evropian mbështet në mënyrë aktive miratimin e SUMP-it dhe jep udhëzime për përgatitjen e këtij lloji të planifikimit, siguron promovimin e praktikave të mira, si dhe mbështetjen për edukimin e profesionistëve në këtë sferë.

Gjithnjë më të mëdha janë zotimet në Union që SUMP-i të jetë i domosdoshëm për qytetet me madhësi të caktuar, në përputhje me standardet kombëtare të bazuara mbi Udhëzimet e BE-së, ndërsa hulumtohen edhe mundësitë për zhvillimin e një kornize të BE-së për mbështetjen e zbatimit progresiv të SUMP-it në qytetet e BE-së.

## ***Si funksionon plani i mobilitetit urban?***

Plani i mobilitetit urban funksionon si një strategji gjithëpërfshirëse që synon të përmirësojë mënyrën se si qytetet menaxhojnë dhe planifikojnë lëvizjen e njerëzve dhe mallrave. Ai përfshin disa komponentë kryesorë dhe funksione për të siguruar një sistem transporti më efikas, të qëndrueshëm dhe të përballueshëm.

Ja se si funksionon në thelb:

1. **Analiza e Situatës Aktuale** - Fillimisht, bëhet një analizë e detajuar e situatës aktuale të transportit në qytet. Kjo përfshin studimin e infrastrukturës ekzistuese, trafikut, përqindjes së përdorimit të llojeve të ndryshme të transportit (privat, publik, biçikleta, këmbësorë), si dhe identifikimin e sfidave kryesore si ndotja e ajrit, trafiku i rënduar, dhe siguria rrugore.
2. **Vendosja e Objektivave** - Bazuar në analizën fillestare, vendosen objektiva të qarta dhe të matshme për përmirësimin e mobilitetit.

Këto objektiva mund të përfshijnë:

- ✓ Reduktimin e ndotjes së ajrit dhe emetimeve të karbonit.
- ✓ Uljen e përdorimit të automjeteve private dhe nxitjen e transportit publik dhe mjeteve të qëndrueshme si biçikletat dhe ecja.
- ✓ Përmirësimin e sigurisë rrugore dhe zvogëlimin e aksidenteve.
- ✓ Rritjen e aksesibilitetit dhe përfshirjes për të gjitha grupet shoqërore.

3. **Zhvillimi i Politikave dhe Masave Konkretizuese**- Plani harton masa konkrete për të arritur objektivat e tij.

Këto masa mund të përfshijnë:

- ✓ **Zhvillimi i Infrastrukturës së Transportit Publik:** Krijimi ose përmirësimi i rrjetit të transportit publik (autobusë, tramvaj, metro), duke siguruar frekuencë dhe kosto të përballueshme.  
Promovimi i Transportit Aktiv: Krijimi i korsive për biçikleta, zgjerimi i hapësirave për këmbësorë dhe krijimi i rrugëve të sigurta për këto kategori.
- ✓ **Menaxhimi i Trafikut:** Zbatimi i sistemeve inteligjente për menaxhimin e trafikut, përfshirë semaforët inteligjentë dhe monitorimin në kohë reale të rrugëve.
- ✓ **Zonat pa Automjete:** Krijimi i zonave ku automjetet private janë të ndaluara, siç janë qendrat historike të qyteteve ose zona të dedikuara për këmbësorë.
- ✓ **Zhvillimi i Automjeteve Elektrike dhe Karikimi:** Vendosja e pikave të karikimit për automjetet elektrike dhe nxitja e përdorimit të tyre.

4. **Përdorimi i Teknologjisë dhe Inovacionit** - Teknologjia luan një rol të rëndësishëm në funksionimin e planit të mobilitetit urban. Kjo përfshin përdorimin e platformave dixhitale për transportin publik (si aplikacione për oraret e autobusëve), sistemet inteligjente të menaxhimit të trafikut dhe përdorimin e të dhënave për të monitoruar dhe përmirësuar lëvizshmërinë në kohë reale.
5. **Monitorimi dhe Vlerësimi i Progresit** - Për çdo hap të planit, bëhet monitorimi i rregullt për të siguruar që masat e ndërmarra janë efektive dhe po përmbushin objektivat e vendosura. Ky monitorim ndihmon në adaptimin e politikave sipas nevojave dhe sfidave të reja që mund të shfaqen.
6. **Përfshirja e Publikut dhe Bashkëpunimi** - Një pjesë thelbësore e funksionimit të planit është përfshirja e qytetarëve dhe aktorëve të ndryshëm në procesin e hartimit dhe zbatimit. Kjo përfshin konsultimet publike, përfshirjen e komuniteteve lokale dhe bashkëpunimin me sektorin privat për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme. Në thelb, plani i mobilitetit urban është një mekanizëm që balancon nevojat e lëvizjes së qytetarëve me qëllimet afatgjata të qëndrueshmërisë, sigurisë dhe zhvillimit urban.

## Qëllimet dhe objektivat e PMQU

Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU) për Komunën e Podujeves ka për qëllim përmirësimin e trafikut dhe transportit duke krijuar një rrjetit rrugor funksional i cili do të mundësojë lidhjen e qytetit duke bërë sistemin e mobilitetit urban më të qëndrueshëm.

Plani i mobilitetit të qëndrueshëm urban synon të krijojë një sistem transporti efikas dhe të qëndrueshëm, duke përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve në tërë territorin e komunës dhe duke reduktuar ndikimet negative në mjedis.

Qëllimet dhe objektivat kryesore të këtij plani përfshijnë:

1. Reduktimi i Ndikimeve Mjedisore
  - ✓ Reduktimi i emetimeve të gazeve serrë dhe ndotjes së ajrit përmes nxitjes së përdorimit të transportit publik, automjeteve elektrike dhe lëvizjeve aktive (si ecja dhe çiklizmi).
  - ✓ Përmirësimi i cilësisë së ajrit në zonat urbane duke zvogëluar trafikun e automjeteve private dhe promovimin e zgjidhjeve alternative të transportit që përdorin energji të pastër
2. Promovimi i Transportit të Qëndrueshëm
  - ✓ Nxitja e transportit publik si opsioni parësor i lëvizjes për banorët, përmes përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve.
  - ✓ Promovimi i transportit aktiv (ecja dhe biçikletat) duke zgjeruar korsi të për biçikleta, krijuar trotuare të sigurta dhe lidhje të mira midis këtyre formave të transportit dhe transportit publik.
3. Reduktimi i Trafikut dhe Përmirësimi i Sigurisë Rrugore
  - ✓ Zvogëlimi i përdorimit të automjeteve private, veçanërisht në zonat e dendura urbane, duke krijuar zona të dedikuara pa makina dhe nxitjen e përdorimit të automjeteve me kapacitet të lartë ose transport të përbashkët.
  - ✓ Përmirësimi i sigurisë rrugore për të gjithë përdoruesit e rrugës, duke reduktuar aksidentet dhe rreziqet për këmbësorët dhe çiklistët përmes masave inxhinierike, edukative dhe zbatimit të ligjit.
4. Rritja e Aksesibilitetit dhe Përfshirjes Sociale
  - ✓ Sigurimi i aksesit të barabartë në transport për të gjithë qytetarët, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe ata që jetojnë në zona të largëta urbane ose me qasje të kufizuara në transport.
  - ✓ Ulja e varësisë nga automjetet private për qytetarët me të ardhura më të ulëta përmes zhvillimit të alternativave të përballueshme të transportit.
5. Përmirësimi i Efikasitetit të Sistemit të Transportit
  - ✓ Optimizimi i rrjeteve të transportit për të minimizuar bllokimet dhe për të rritur efikasitetin e transportit publik, përmes sistemeve të menaxhimit të trafikut dhe përdorimit të teknologjive të avancuara (p.sh., sistemet e transportit inteligjent).
  - ✓ Koordinimi i transportit urban dhe zhvillimit të qëndrueshëm urbanistik, duke planifikuar qytetet në mënyrë që të reduktohet nevoja për lëvizje të gjata dhe të nxisin përdorimin e mënyrave të qëndrueshme të transportit.



#### 6. Rritja e Vetëdijes dhe Edukimit mbi Mobilitetin e Qëndrueshëm

- ✓ Nxitja e ndryshimit të sjelljeve përmes fushatave të edukimit dhe ndërgjegjësimit për përfitimet e lëvizjes së qëndrueshme dhe mjedisore.
- ✓ Angazhimi i komunitetit në proceset e planifikimit dhe zbatimit të masave të mobilitetit të qëndrueshëm për të krijuar një ndjenjë pronësie dhe përgjegjësie mbi ndryshimet.

#### 7. Integrimi i Teknologjisë së Avancuar

- ✓ Përdorimi i teknologjive të transportit inteligjent për menaxhimin e trafikut, oraret e transportit publik dhe informimin e qytetarëve në kohë reale për opsionet më të mira të lëvizjes.
- ✓ Zhvillimi i infrastrukturës për automjete elektrike dhe promovimi i përdorimit të energjisë së rinovueshme për transport.

#### 8. Zhvillimi Ekonomik dhe Konkurrueshmëria e Qytetit

- ✓ Nxitja e zhvillimit ekonomik të qytetit përmes krijimit të një sistemi transporti të integruar dhe efikas, që ndihmon në rritjen e aksesit në tregje dhe shërbime.
- ✓ Përmirësimi i cilësisë së jetës për banorët dhe atraktiviteti për turistët dhe investitorët përmes përmirësimit të infrastrukturës së transportit dhe reduktimit të ngarkesave në rrugë. Këto qëllime dhe objektiva ndihmojnë në ndërtimin e një sistemi transporti që mbështet zhvillimin urban të qëndrueshëm, përmirëson mirëqenien e qytetarëve dhe mbron mjedisin për gjeneratat e ardhshme.

### Fushëveprimi i PMQU

Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU) duhet të adresojë të gjitha mënyrat dhe format e transportit brenda një zone urbane, duke përfshirë lëvizjet e motorizuara (automjetet personale, autobusët, automjete të lehta dhe të rënda transportuese, motoçikleta) dhe jo-motorike (ecje dhe çiklizëm). PMQU gjithashtu duhet të vlerësojë nevojat dhe përparësitë e të gjithë palëve të interesuara (publike dhe private), duke synuar rritjen e shkallës së sigurisë në trafik, efikasitetin socio-ekonomik dhe uljen e ndotjes.

Meqenëse një sistem i qëndrueshëm i lëvizshmërisë urbane nuk është i bazuar veçanërisht në një zonë administrative, por në një "zonë funksionuese të bazuar në modelet e udhëtimit në punë", PMQU për komunën e Podujevës adreson sistemet e lëvizshmërisë në tërë territorin e komunës.

Fushëveprimi i planit të mobilitetit të qëndrueshëm urban përfshin një gamë të gjerë elementësh dhe aspektesh të lidhura me lëvizjen dhe transportin brenda zonave urbane. Ky plan adreson nevojat aktuale dhe të ardhshme për transport, duke marrë parasysh zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor të qytetit.

Fushëveprimi përfshin disa shtylla kryesore:

#### 1. Transporti Publik

- ✓ Zhvillimi dhe zgjerimi i rrjeteve të transportit publik, duke përfshirë autobusat, tramvajet, trenat urbanë dhe metro.
- ✓ Përmirësimi i shërbimeve të transportit publik për të bërë ato më efikase, të përballueshme, të aksesueshme dhe me frekuencë më të madhe.

- ✓ Integrimi i sistemeve të ndryshme të transportit për të krijuar një rrjet të pandërprerë që lehtëson lëvizjen ndërmjet formave të ndryshme të transportit (p.sh., lidhjet ndërmjet autobusëve dhe trenave).
2. Transporti Aktiv
- ✓ Inkurajimi i ecjes dhe çiklizmit si forma të qëndrueshme të transportit. Kjo përfshin zhvillimin e korsive për biçikleta, zgjerimin e hapësirave për këmbësorë dhe krijimin e infrastrukturës që rrit sigurinë dhe komoditetin e përdoruesve të këtyre mjeteve.
  - ✓ Krijimi i hapësirave të dedikuara për këmbësorë dhe çiklistë, duke përmirësuar sigurinë rrugore dhe përjetimin e mjedisit urban.
3. Infrastrukturë për Automjete Elektrike dhe të Gjelbërta
- ✓ Promovimi i automjeteve me energji të pastër si makina elektrike dhe hibride përmes zgjerimit të pikave të karikimit dhe krijimit të incentivave për qytetarët që përdorin këto mjete.
  - ✓ Zhvillimi i një rrjeti të qëndrueshëm të karikimit për automjetet elektrike në vendet strategjike urbane.
4. Menaxhimi i Trafikut
- ✓ Përdorimi i sistemeve inteligjente të menaxhimit të trafikut për të monitoruar dhe rregulluar rrjedhën e automjeteve, duke zvogëluar ngarkesat në rrugë dhe ulur kohën e udhëtimit.
  - ✓ Zhvillimi i zonave me trafik të kufizuar (p.sh., zona pa makina ose zona me hyrje të kufizuara të automjeteve) për të ulur ndotjen dhe për të krijuar mjedise më të qeta dhe të sigurt për këmbësorët dhe çiklistët.
5. Reduktimi i Përdorimit të Automjeteve Private
- ✓ Nxitja e përdorimit të transportit të përbashkët (car-sharing, ride-sharing) për të ulur numrin e automjeteve private në qytet dhe për të zvogëluar trafikun.
  - ✓ Krijimi i parkingjeve park & ride që lejojnë qytetarët të parkojnë automjetet e tyre në periferi dhe të përdorin transportin publik për të hyrë në qendrat e qyteteve.
6. Zhvillimi Urban i Qëndrueshëm
- ✓ Koordinimi i politikave të mobilitetit me planifikimin urban, duke krijuar një strukturë qyteti ku banesat, shërbimet dhe vendet e punës janë më të afërta dhe më lehtë të arritshme përmes lëvizjeve të qëndrueshme.
  - ✓ Zhvillimi i zonave urbane të përziara (zona ku kombinohen banesa, tregti dhe shërbime), duke reduktuar nevojën për udhëtime të gjata me automjete private.
7. Mbrojtja e Mjedisit dhe Ndikimi në Shëndet
- ✓ Zvogëlimi i ndotjes së ajrit dhe zhurmës përmes masave që reduktojnë përdorimin e automjeteve private dhe promovojnë transportin me ndikim të ulët mjedisor.
  - ✓ Inkurajimi i një mjedisi më të shëndetshëm urban për qytetarët, përmes krijimit të më shumë hapësirave të gjelbra dhe përmirësimit të aksesit në zona për rekreacion dhe lëvizje të sigurt.
8. Përfshirja Sociale dhe Aksesueshmëria
- ✓ Zhvillimi i një sistemi transporti të aksesueshëm për të gjithë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe familjet me të ardhura të ulëta.
  - ✓ Ulja e përjashtimit social përmes përmirësimit të aksesit në transport për të gjitha shtresat shoqërore dhe zonat e largëta urbane.

9. Rritja e Ndërgjegjësimit dhe Edukimit

- ✓ Zhvillimi i fushatave për ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi përfitimet e përdorimit të mënyrave të qëndrueshme të transportit dhe ndikimet pozitive në mjedis dhe shëndet.
- ✓ Përfshirja e komunitetit në proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes për masat e mobilitetit, duke siguruar që zgjidhjet të reflektojnë nevojat e tyre.

10. Koordinimi Ndër-Institucional dhe Financimi

- ✓ Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve publike dhe private për të zbatuar politika dhe masa të koordinuara që mbështesin mobilitetin e qëndrueshëm.
- ✓ Sigurimi i burimeve financiare nga fondet publike dhe private për zbatimin e projekteve të infrastrukturës dhe zhvillimit të mobilitetit të qëndrueshëm. Në përgjithësi, fushëveprimi i planit të mobilitetit të qëndrueshëm urban mbulon të gjitha aspektet e transportit dhe lëvizjes brenda një qyteti, duke integruar zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe mjedisor për të ndërtuar një sistem transporti të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

# PLANIFIKIMI TRADICIONAL I TRANSPORTIT




Fig.1. Fushëveprimi i PMQU

## KORNIZA LIGJORE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e përkufizon komunën si njësi themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale dhe përcakton që kompetencat e komunës përcaktohen me Ligj.<sup>1</sup> Në bazë të Kushtetutës, komuna gëzon shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale. Kushtetuta i garanton shprehimisht komunës të drejtën për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkufitar, të drejtën e mbledhjes dhe shpenzimit të hyrave vetanake dhe të drejtën e pranimit të fondeve qeveritare.<sup>2</sup>

Rrjedhimisht, Kushtetuta ka përcaktuar që kompetencat e Komunës përcaktohen më konkretisht përmes ligjeve. Lidhur me këtë, në fushën e mobilitetit apo menaxhimit të transportit, Komunës i janë dhënë kompetencat përmes ligjeve të ndryshme, prej të cilëve më të rëndësishmit janë:

1. Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;
2. Ligji Nr. 08/L-275 për Rrugët;
3. Ligji Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor, ndryshuar dhe plotësuar me anë të Ligjit Nr. 06/L-070;
4. Ligji Nr. 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor;
5. Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor;
6. Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit.

### 1. Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar kompetencat e komunës të cilat mund të jenë vetanake (ekskluzive) dhe të deleguara. Kompetencat të cilat i janë dhënë komunës në fushën e menaxhimit të transportit janë të gjitha kompetenca vetanake apo ekskluzive dhe për ushtrimin e këtyre kompetencave komuna ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë dhe autonomi të plotë të veprimit. Përmes Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, komunës i janë dhënë këto kompetenca vetanake dhe ekskluzive në fushën e menaxhimit të transportit:

- Kompetenca për planifikim urban dhe rural;<sup>3</sup>
- Kompetenca për menaxhimin e rrugëve lokale dhe transportit lokal<sup>4</sup>
- Kompetenca për licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve lidhur me transportimin publik dhe taksitë<sup>5</sup>
- Kompetenca për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike<sup>6</sup>
- Kompetenca për mbrojtjen e mjedisit lokal.<sup>7</sup>

### 2. Ligji për Rrugët

Ligji për Rrugët ka përcaktuar kompetencat e komunës lidhur me menaxhimin e rrugëve të cilat gjenden brenda territorit të komunës. Ky Ligj i jep kompetencë komunës që të menaxhojë të gjitha rrugët publike lokale brenda territorit të saj, t'i mirëmbaj rrugët, t'i ndërtojë dhe riparoj rrugët, t'i

<sup>1</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 12

<sup>2</sup> Ibid, Neni 124

<sup>3</sup> Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Neni 17, pika b)

<sup>4</sup> Ibid, Neni 17, pika f)

<sup>5</sup> Ibid, Neni 17, pika n)

<sup>6</sup> Ibid, Neni 17, pika o)

<sup>7</sup> Ibid, Neni 17, pika e)

vendos dhe t'i mirëmbaj shenjat e trafikut rrugor, si dhe të mbikëqyr zbatimin e dispozitave të Ligjit për Rrugët përmes inspektorëve komunal.

Përmes Ligjit për Rrugët, komunës i janë dhënë këto kompetenca:

- Komuna është autoritet për rrugë publike lokale;<sup>8</sup>
- Komuna mund të propozoj që një rrugë publike lokale t'i hiqet statusi i rrugës publike<sup>9</sup>;
- Komuna mund të kategorizojë rrugët lokale përmes akteve nënligjore të saj<sup>10</sup>;
- Komuna jep leje për ndërtimin dhe rindërtimin e rrugëve lokale dhe objekteve tjera përcjellëse në to<sup>11</sup>;
- Komuna ka kompetencë të përcaktojë përshkrimin e punëve të sinjalizimit, pajisjeve dhe ndriçimit rrugor, specifikimin e punëve të caktuara dhe afateve për realizimin e këtyre punëve, rregullat dhe kushtet teknike për ekzekutimin e punëve dhe të gjitha çështjet tjera lidhur me to përmes rregullores së veçantë<sup>12</sup>;
- Komuna ka kompetencë të përcaktojë përshkrimin e punëve të mirëmbajtjes së rrugëve publike lokale, specifikimin e punëve të caktuara dhe afateve për realizimin e këtyre punëve, rregullat dhe kushtet teknike për ekzekutimin e punëve dhe të gjitha çështjet tjera lidhur me to, përmes rregullores së veçantë<sup>13</sup>;
- Komuna është përgjegjëse që t'ia përcjell të dhënat lidhur me rrugët të cilat i menaxhon Agjencisë së Rrugëve të Kosovës<sup>14</sup>;
- Komuna është kompetente të përcaktojë kushtet, kriteret dhe procedurat për lëshimin, pezullimin dhe revokimin e lejes për ndërtim dhe përdorim të kyçjes për rrugët nën përgjegjësinë e komunave përmes aktit nënligjor<sup>15</sup>;
- Komuna përcakton kushtet për projektimin dhe ndërtimin e vendeve për ndaljen e autobusëve në rrugët të cilat janë nën menaxhimin e Komunës<sup>16</sup>;
- Komuna nxjerr vendimin për zhvendosjen e rrugës publike e cila është nën menaxhimin e Komunës<sup>17</sup>;
- Komuna lëshon lejen e ndërtimit për ndërtimet të cilat bëhen në parcelat që gjenden ngjitur me rrugën publike të cilën e menaxhon Komuna;<sup>18</sup>
- Komuna mbikëqyr rregullsinë e vendosjes së reklamave pranë rrugëve publike të cilat gjenden në menaxhim të Komunës përmes rregullores së veçantë;<sup>19</sup>
- Komuna rregullon Sistemin Inteligjent të Transportit (SIT) përmes rregullores së veçantë për rrugët të cilat i ka në menaxhim<sup>20</sup>;

<sup>8</sup> Ligji për Rrugët, Neni 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2

<sup>9</sup> Ibid, Neni 6, paragrafi 2

<sup>10</sup> Ibid, Neni 7, paragrafi 2

<sup>11</sup> Ibid, Neni 10, paragrafi 3

<sup>12</sup> Ibid, Neni 13

<sup>13</sup> Ibid, Neni 14

<sup>14</sup> Ibid, Neni 16

<sup>15</sup> Ibid, Neni 19

<sup>16</sup> Ibid, Neni 21

<sup>17</sup> Ibid, Neni 22

<sup>18</sup> Ibid, Neni 23, paragrafi 6 dhe 7

<sup>19</sup> Ibid, Neni 26

<sup>20</sup> Ibid, Neni 44, paragrafi 5

- Komuna bën identifikimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e vendeve me rrezikshmëri të lartë në infrastrukturën rrugore<sup>21</sup>;
- Komuna është përgjegjëse për mbikëqyrjen administrative në zbatimin e Ligjit për Rrugët dhe akteve të cilat rregullojnë statusin e rrugëve të pakategorizuara dhe lokale<sup>22</sup>;
- Komuna është përgjegjëse për punët e inspektimit në rrugët publike lokale dhe të pakategorizuara përmes Inspektoratit Komunal<sup>23</sup>;
- Komuna, me akt nënligjor rregullon organizimin, kompetencat, të drejtat, përgjegjësitë e inspektoratit dhe të inspektorit si dhe procedurat për zbatimin e Ligjit për Rrugët<sup>24</sup>;
- Komuna, përmes Kryetarit të Komunës detyrohet të themeloj Komisionin e Ankesave i cili është përgjegjës të trajtoj ankesat ndaj vendimeve të cilat i merr Komuna në kuadër të zbatimit të Ligjit për Rrugët.<sup>25</sup>

### 3. Ligji për Transportin Rrugor

Ligji për Transportin Rrugor i jep më së shumti kompetenca Komunës në lidhje me menaxhimin e transportit. Në këtë Ligj buron e drejta e Komunës që të hartoj planin e mobilitetit dhe të përcaktojë politikat dhe strategjitë e zhvillimit të shërbimeve publike në fushën e transportit rrugor në atë mënyrë që këto të shërbime të jenë të sigurta, efikase dhe ekonomike brenda territorit të komunës. Ky Ligj përcakton që plani i mobilitetit të jetë në harmoni me rrjetin e linjave ndërurbane të aprovuara nga Ministria dhe politikat e zhvillimit të gjithëmbarshtëm të transportit rrugor në Kosovë të cilat miratohen nga Ministria përgjegjëse për Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë.

Ligji për Transportin Rrugor i jep të drejtën Komunës që të nxjerr akte administrative për rregullimin e operimit të autobusëve, taksive dhe të gjitha mjeteve të cilat përdoren për transportin e udhëtarëve brenda komunës. Ky Ligj përcakton të drejtën e komunës që të përcaktojë linjat e transportit dhe të drejtën që të licencojë operatorët të cilët merren me transportin e udhëtarëve brenda komunës. Përveç kësaj, Ligji për Transportin Rrugor i jep të drejtë komunës që të lidh marrëveshje me komuna të tjera për organizimin e përbashkët të transportit të udhëtarëve, me kusht që një marrëveshje e tillë të aprovohet nga Ministria përkatëse për Infrastrukturë. Gjithashtu, Ligji për Transportin Rrugor ka përcaktuar kompetencën e komunës që të inspektoj zbatimin e legjislacionit për transport rrugor të udhëtarëve dhe mallrave përmes inspektorëve të transportit rrugor të cilët këtë kompetencë e ushtrojnë në bashkëpunim me policinë.

Kompetencat të cilat i janë dhënë komunës me anë të Ligjit për Transportin Rrugor janë:

- Komuna përcakton politikat e zhvillimit të shërbimeve të transportit rrugor të sigurta, efikase dhe ekonomike brenda kufijve administrativë të komunës;<sup>26</sup>
- Komuna harton dhe aprovon planin e transportit rrugor lokal dhe e ndryshon atë sipas nevojës varësisht nga rrethanat e krijuara, i cili nuk duhet të jetë në kundërshtim me rrjetin e linjave ndërurbane të aprovuar dhe publikuar nga Ministri<sup>27</sup>. Komuna ndryshon atë plan jo më vonë së pesë

<sup>21</sup> Ligji për Rrugët, Neni 49, paragrafi 2

<sup>22</sup> Ligji për Rrugët, Neni 52

<sup>23</sup> Ibid, Neni 53

<sup>24</sup> Ibid, Neni 54, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7

<sup>25</sup> Ibid, Neni 57, paragrafi 3, nën-paragrafi 3.3

<sup>26</sup> Ligji për Transportin Rrugor, Neni 6.1

<sup>27</sup> Ibid, Neni 6.2, 6.3 dhe 6.4

vite nga data e nxjerrjes së tij, i cili duhet të jetë në përputhshmëri me politikën e zhvillimit të tërësishëm të transportit rrugor në Kosovë. Komuna, publikon planin apo planin e ndryshuar dhe një kopje të tij ia dërgon Ministrisë;

- Komuna mund të nxjerr akte administrative përmes të cilave cakton rregullat lidhur me operimin e operatorëve/autobusëve me kusht që këto rregulla të mos paragjykojnë/ dëmtojnë të drejtat dhe interesat e asnjërës prej bashkësive, të cilat respektohen mirëfilli dhe të cilat përfshijnë: rregullimin ose ndalimin e përdorimit të autobusëve publik në rrugë të caktuara ose rajone që kanë lidhje me rrugë, marrja dhe zbritja e udhëtarëve dhe çështje tjera lidhur me transportin rrugor të udhëtarëve, krijimi dhe mbajtja (ruajtja) e regjistrave dhe inspektimi i tyre, transporti i bagazhit të udhëtarëve ose mallrave tjera; rregullimin ose ndalimin e transportit të udhëtarëve që qëndrojnë në këmbë, shpejtësia maksimale e autobusëve publik, dizajni, pajisja, mjetet (të brendshme ose të jashtme) të autobusëve publik, pikat e stacioneve dhe vend-ndaljet në linjat për autobus dhe rregullimin ose ndalimin e shpalljeve, shenjave dhe reklamave brenda apo jashtë autobusëve publik;<sup>28</sup>
- Komuna ka kompetencë të certifikojë automjetet me më shumë se tetë plus një (8 + 1) ulëse për transportin urban dhe urbano-periferik;<sup>29</sup>
- Komuna me akt nënligjor përcakton kriteret për dhënien dhe revokimin e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve në territorin e komunës së saj;<sup>30</sup>
- Komuna me akt nënligjor do të përcaktoj kushtet dhe kriteret teknike-eksplotuese dhe higjienike të automjeteve të transportit rrugor të udhëtarëve;<sup>31</sup>
- Komuna është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit brenda territorit të saj si: transportin e rregullt të udhëtarëve, transportin e lirë të udhëtarëve; transportin taksi të udhëtarëve; transportin e udhëtarëve për nevoja vetanake;<sup>32</sup>
- Komuna mund të subvencionojë transportin urban dhe urban-periferik;<sup>33</sup>
- Komuna me akt nënligjor do të përcaktoj kushtet, procedurat, mënyrën e përzgjedhjes së relacioneve, tarifave si dhe do të përcaktoj linjat të cilat mund të subvencionohen;<sup>34</sup>
- Komuna nxjerr akt të veçantë juridik me anë të cilit rregullon transportin e rregullt urban dhe urban-periferik të udhëtarëve me autobus, si transport i udhëtarëve në qarkullimin rrugor publik;<sup>35</sup>
- Rrjeti i linjave urbane dhe urban-periferik si dhe numri i orareve në to miratohet nga Komuna<sup>36</sup>
- Dy komuna mund të arrijnë marrëveshje për rregullimin reciprok të transportit të udhëtarëve në mes veti. Marrëveshja është e plotfuqishme nëse aprovohet nga Ministria<sup>37</sup>

<sup>28</sup> Ligji për Transportin Rrugor, Neni 6.5

<sup>29</sup> Ibid, Neni 6.6

<sup>30</sup> Ibid, Neni 7.8

<sup>31</sup> Ibid, Neni 12.2

<sup>32</sup> Ibid, Neni 15.2

<sup>33</sup> Ibid, Neni 17.3

<sup>34</sup> Ibid, Neni 17.5

<sup>35</sup> Ibid, Neni 17.6

<sup>36</sup> Ibid, Neni 17.7

<sup>37</sup> Ibid, Neni 17.10



- Komuna rregullon transportin e veçantë të udhëtarëve i cili është transporti i grupeve të caktuar udhëtarësh duke përjashtuar udhëtarët tjerë në relacion të caktuar dhe në bazë të lejes së veçantë. Me transport të veçantë të udhëtarëve kryhet transporti: nxënësve dhe studentëve nga vendbanimi deri të destinacion dhe anasjelltas. punëtorëve nga vendbanimi deri në punë dhe anasjelltas. invalidëve dhe personave me përkujdesje të veçantë. Lejet për transport të veçantë lëshohen në bazë të kontratës e cila duhet të ketë: relacionin; listën e udhëtarëve; çmimin e transportit; vendet për marrje dhe zbritje të udhëtarëve; kohën gjatë së cilës kryhet transporti.<sup>38</sup> Lejen për këtë lloj transporti e lëshon organi kompetent komunal nëse transporti kryhet brenda një komune respektivisht Ministria nëse ky transport kryhet në territorin e dy e më tepër komunave<sup>39</sup>
- Komuna do të nxjerr rregullore të veçantë për mënyrën e kryerjes së transportit të udhëtarëve me "taksi";<sup>40</sup>
- Veprimtaria e transportit për nevoja vetanake i nënshtrohet marrjes së një autorizimi/certifikate, të lëshuar nga Ministria respektivisht Komuna, varësisht nga kompetencat që ushtrojnë në bazë të ligjit;<sup>41</sup>
- Licencën për kryerjen e veprimtarisë së shërbimeve të stacionit të autobusëve e lëshon Ministri, nëse stacioni i autobusëve është i destinuar për kryerjen e shërbimeve në transportin ndër-urban dhe të jashtëm. Ndërsa për stacionet që janë të destinuara për kryerjen e shërbimeve të transportit urban licencën e lëshon Komuna.<sup>42</sup>
- Komuna, krahas Ministrisë dhe Policisë bën mbikëqyrjen dhe kontrollin mbi zbatimin e Ligjit për transportin rrugor dhe të akteve nënligjore të nxjerra mbi bazë të tij, përmes inspektorëve rrugorë, bazuar në kompetencat që i janë dhënë me ligj;<sup>43</sup>
- Punët e inspektimit në transportin rrugor urban, urban periferik, mallrave dhe transportin auto taksi brenda territorit të komunës i bënë inspektori i transportit rrugor komunal dhe Policia e Kosovës (policia e trafikut) në kuadër të kompetencave të veta të përcaktuara me ligj.<sup>44</sup>

#### 4. Ligji për Rregullat e Trafikut Rrugor

Ligji për Rregullat e Trafikut Rrugor parasheh kompetenca të rëndësishme për Komunën në çështjet e rregullimit të trafikut rrugor. Ky Ligj i jep të drejtën Komunës që të përcaktoj edhe rregullat e trafikut dhe të bëj mbikëqyrjen e këtyre rregullave në rrugët të cilët i administron Komuna, mirëpo këto rregulla duhet t'i vendos dhe t'i mbikëqyr në bashkëpunim me Policinë e Kosovës. Kompetencat të cilat i njihen Komunës përmes Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor janë:

- Komuna, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe në konsultim me komunitetin, bëjnë rregullimin teknik të trafikut nëpër rrugët publike nën administrimin përkatës të tyre. Rregullimi teknik i trafikut i përfshinë të gjitha masat dhe aktivitetet që merren për të ofruar qarkullim të

<sup>38</sup> Ligji për Transportin Rrugor, Neni 25, paragrafi 1

<sup>39</sup> Ibid, Neni 25, paragrafi 5

<sup>40</sup> Ibid, Neni 32

<sup>41</sup> Ibid, Neni 35

<sup>42</sup> Ibid, Neni 39, paragrafi 5

<sup>43</sup> Ibid, Neni 49

<sup>44</sup> Ibid, Neni 50, paragrafi 2

sigurt në trafikun rrugor, e të cilat përfshijnë: rrugën me përparësi kalimi; trafikun me një apo dy kahje; mbylljen e rrugës ose një pjese të rrugës për qarkullim të mjeteve, me kohë të caktuar ose të pacaktuar; sistemin teknik të rregullimit të trafikut; kufizimin e shpejtësisë së lëvizjes; lëvizjen e këmbësorëve, të biçikletave, të mopedëve, të trotineteve, të qerreve, grahjen dhe tërheqjen e kafshëve; hapësirën dhe mënyrën e parkimit, zonën e trafikut të qetë, zonën e shkollës, zonën e kufizimit të shpejtësisë, pajisjet teknike për ngadalësim të shpejtësisë; bllokimin e autobusëve, të mjeteve transportuese, të mjeteve të bashkëngjitura dhe makinave të punës në vende të cilat nuk janë të paracaktuara për parkim, si dhe mënyrën e zhbllokimit; vendosjen dhe mirëmbajtjen e rrethojës mbrojtëse për këmbësorë në vende të rrezikshme; zonën e këmbësorëve, drejtimet e sigurta për lëvizje të fëmijëve shkollorë, masat e veçanta teknike për siguri të këmbësorëve dhe biçiklistëve në afërsi të institucioneve mësimore, shëndetësore dhe institucioneve të tjera, të fushave sportive, të çerdheve të fëmijëve, të kinemave e të ngjashme; largimin e automjeteve të vjetruara, të dëmtuara, të paregjistruara ose të braktisura; largimin e automjeteve për qëllim biznesi që pengojnë mbarëvajtjen e trafikut, si shitblerjen në vende publike, rrugë dhe trotuar; hapësirat në të cilat kryhen testime të drejtimit të mjetit rrugor, drejtimi në terren, drejtimi jashtë rrugës, garat sportive dhe të ngjashme; kushtet e lëvizjes së mjeteve për furnizim në zonat e trafikut të qetë dhe në zonat e këmbësorëve; sistemin e rregullimit teknik të qarkullimit rrugor përmes sistemit elektronik dhe të video mbikëqyrjes.<sup>45</sup>

- Zona e shkollës përcaktohet nga Ministria dhe Komuna, në konsultim me Ministrinë përkatëse të Arsimit;<sup>46</sup>
- Mbikëqyrjen e parkimit të mjeteve në vendet në të cilën është e kufizuar kohëzgjatja, e kryejnë përfaqësuesit e autorizuar nga Komuna<sup>47</sup>;
- Mbikëqyrjen e kohëzgjatjes së përgjithshme të të drejtuarit të mjetit, pushimin e shoferit, tahografit, pajisjeve, mjeteve në pikëpamje të masës më të madhe të lejuar, dimensionet dhe ngarkesat boshtore, mjetet të cilat kryejnë transportin publik të udhëtarëve dhe mallit, mjeteve të cilat bartin materiet e rrezikshme, mjetet që transportojnë kafshët, veturat taksi e të ngjashme, përveç personit të autorizuar nga Policia e kryejnë edhe inspektori i autorizuar nga Komuna në kuadër të kompetencave të tij të përcaktuara me ligj<sup>48</sup>;
- Mbikëqyrjen dhe rregullimin e trafikut e bëjnë punëtorët e subjektit të kontraktuar nga Komuna, pas marrjes së pëlqimit nga Komuna, në segmentin e rrugës ku zhvillohen punimet.<sup>49</sup>
- Pjesa e rrugës në të cilën janë paraqitur pengesa që nuk mund të mënjanoen menjëherë ose aty ku kryhen punime, duhet të shënohet në mënyrë të dukshme përmes materialeve retro-reflektuese, me qëllim që të sigurohen pjesëmarrësit në trafik. Nëse largimi i pengesave nga rruga është i pamundshëm, ato duhet të shënohen në mënyrë të tillë që të jenë të dukshme ditën dhe natën. Vendosjen e shenjave përkatëse në rrugë e bën personi i autorizuar nga Komuna;<sup>50</sup>

<sup>45</sup> Ligji për Rregullat e Trafikut Rrugor, Neni 4, paragrafi 1 dhe 2

<sup>46</sup> Ibid, Neni 4, paragrafi 3

<sup>47</sup> Ibid, Neni 7

<sup>48</sup> Ibid, Neni 8, paragrafi 2

<sup>49</sup> Ibid, Neni 8, paragrafi 5

<sup>50</sup> Ibid, Neni 10, paragrafi 1 dhe 2

- Komuna mund të lejojë shfrytëzimin e pjesës së trotuarit me rrethojë, vendosje të tavolinave, ulëseve, qoshqeve ose të ngjashme, me kusht që nuk kufizohet ose pengohet fushëpamja e rrugës dhe që lëvizja e këmbësorëve të jetë e papenguar dhe e sigurt, duke lënë hapësirë të trotuarit me gjerësi prej së paku një pikë gjashtë (1.6) metrash;<sup>51</sup>
- Komuna, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, mund ta zvogëlojë ose ta rrisë shpejtësinë e kufizuar brenda vendbanimit me anë të shenjave përkatëse të trafikut<sup>52</sup>
- Komuna, në bashkëpunim me Policinë, me anë të shenjave përkatëse të trafikut mund ta zvogëlojë shpejtësinë e kufizuar jashtë vendbanimit, në rrugë ose në një segment të saj, nëse kushtet e trafikut e kërkojnë këtë<sup>53</sup>
- Komuna i përcakton me akt nënligjor rregullat e lëvizjes së kafshëve, ndalimin e drejtimit të kafshëve në rrugë të caktuara apo në zona të caktuara brenda një kohe specifike, si dhe qarkullimin e qerreve për transport të mallrave dhe njerëzve apo të ngjashme, si dhe çështje të tjera lidhur me to<sup>54</sup>;
- Për mbajtje të manifestimeve sportive dhe manifestimeve të tjera ose aktivitete të ngjashme në rrugë, organizatori duhet të marrë leje nga Komuna, në bashkëpunim me policinë;<sup>55</sup>
- Komuna, me qëllim të mbrojtjes së ambientit mund ta ndalojë ose ta kufizojë qarkullimin në rrugët që i ka nën administrim, për lloje apo kategori caktuara të mjetit, apo për të gjitha mjetet.

## 5. Ligji për Planifikim Hapësinor

Ligji për Planifikim Hapësinor parasheh kompetencat e Komunës lidhur me nxjerrjen e planeve hapësinore, planeve rregulluese të hollësishme, planeve zhvillimore dhe hartave zonale, të cilat duhet të rregullojnë edhe çështjet e transportit publik, përkatësisht mobilitetit brenda Komunës.

## 6. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit

Me anë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit parashihen kompetencat e Komunës për mbrojtjen e mjedisit dhe këto kompetenca kanë të bëjnë edhe me veprimtaritë e transportit të cilat mund të kenë ndikim në mjedis. Ky Ligj i jep të drejtën Komunës që varësisht nga vlerësimi i ndikimit në mjedis të lëshoj leje mjedisore komunale për një aktivitet të caktuar i cili mund të rrjedh nga fusha e transportit, të bëjë vlerësimin e ndikimit në mjedis për projekte që kanë të bëjnë me fushën e transportit, të hartojë planet e veprimtimit lokal në mjedis, të hartojë planet e intervenimit në rast të shkaktimit të aksidenteve mjedisore, paralajmërimin dhe njoftimin e publikut lidhur me ndotjen e ambientit që mund të shkaktohet si pasojë e transportit, shpalljen e statusit të mjedisit të rrezikuar, shpalljen e gjendjes së rrezikshmërisë, si dhe monitorimin dhe mbikëqyrjen inspektuese lidhur me zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit të cilat parashihen me anë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit.

### Aktet komunale në fushën e transportit

Komuna e Podujevës duke u bazuar në kompetencat e saj të cilat i njihen me anë të ligjeve të

<sup>51</sup> Ibid, Neni 32, paragrafi 3

<sup>52</sup> Ibid, Neni 55, paragrafi 1

<sup>53</sup> Ligji për Rregullat e Trafikut Rrugor, Neni 55, paragrafi 5

<sup>54</sup> Ibid, Neni 140, paragrafi 6

<sup>55</sup> Ibid, Neni 218, paragrafi 1

lartpërmendura deri më tani ka nxjerrë disa akte nënligjore me qëllim të zbatimit të këtyre kompetencave. Aktet më të rëndësishme komunale në rregullimin e transportit të cilat janë nxjerrë deri më tani nga Komuna e Podujevës janë:

1. Rregullorja (K.PD.) Nr.01-345/01-0008882/23 për Transportin e Udhëtarëve me Automjete Taksi;
2. Rregullorja(K.PD.) Nr.01-345/01-0008883/23 për Transportin Rrugor në Territorin e Komunës së Podujevës;
3. Rregullorja (K.PD) Nr.01-352/11-0084560/19 për Mbrojtjen e Mjedisit në Komunën e Podujevës;dhe
4. Rregullorja (K.PD) Nr.01-431/04-0014941/18 për Tarifa dhe Gjoha Komunale;

### **METODOLOGJIA E PUNËS**


Analizimi i gjendjes së tanishme të lëvizjes urbane në Komunën e Podujevës është bërë mbi bazën e të dhënave të përfituara nga një proces i gjatë i mbledhjes së tyre. Matjet e fluksit të qarkullimit janë bërë për hyrjet e zonës urbane dhe udhëkryqet të ndryshme .Të dhënat janë sasiore dhe cilësore.

Metodologjia që ka mundur mbledhjen e të dhënave sasiore ka qenë *pyetësori*, i cili në përmbajtjen e tij ka pasur pyetje të mbyllura (me përgjigje të paracaktuara).

PQMU për Podujevën do të bazohet në udhëzuesin për hartimin e planit të mobilitetit, dhe ka për qëllim angazhimin, sa më shumë që të jetë e mundur, të autoriteteve lokale dhe grupeve tjera të interesit me qëllim që të jenë në gjendje të hartojnë planin e mobilitetit urban. Metodologjia e hartimit të PQMU është dhënë në Fig.2.

---

"Libri i Bardhë i Transportit në BE - udhërrëfyes për zonë unike të transportit evropian, 2011"



**Vendimi për të përgaditur PQMU**

- 1.1 Vlerësoni kapacitetet dhe burimet
- 1.2 Krijoni ekipin ndërsëktorial
- 1.3 Kërkonte koordinim të politikës dhe qasje profesionale
- 1.4 Planifikoni përfshirjen e qytetarëve dhe palëve të interesit

**02 Përcaktimi i komitëve dhe planifikimi**

- 2.1 Definoni kërkesat e planit dhe fushëveprimin
- 2.2 Krijoni lidhje me proceset e tjera të planifikimit
- 2.3 Dakordohuni rreth planit të punës dhe strukturave udhëheqëse
- 2.4 Kosideroni mbështetje të jashtme

**03 Analiza e gjendjes së lëvizshmërisë**

- 3.1 Identifikoni burimet e të dhënave
- 3.2 Përgaditni analizën e problemit dhe mundësitë

**04 Ndërtimi dhe vlerësimi i bashkisë së skenarëve**

- 4.1 Zhvilloni skenarët potencial të së ardhmes
- 4.2 Diskutoni skenarët me qytetarët dhe palët e interesit

**05 Zhvillimi i vizionit dhe strategjive me palët e interesit**

- 5.1 Zhvilloni vizionin e përbashkët të mobilitetit me qytetarët dhe palët e interesit
- 5.2 Caktoni prioritetet dhe objektivat e matshme

**06 Vendosja e objektivave dhe indikatorëve**

- 6.1 Identifikoni indikatorët për të gjitha objektivat
- 6.2 Dakordohuni për masat dhe synimet

**07 Caktimi i masave efektive**

- 7.1 Masave integruese
- 7.2 Mësoni nga përvojat e tjera
- 7.3 Përgaditni planin e monitorimit dhe vlerësimin

**Vizioni, objektivat, masat efektive**

Për të qenë efektiv, procesi i planifikimit dhe operimit të sistemit rrugor duhet të bazohet në një **metodologji të fuqishme**.

Qasja duhet të jetë para së gjithash **multimodale** dhe **sistematike**.

**Qasja multimodale:** është e njohur nevoja për të zhvilluar fuqishëm alternativa ndaj automjeteve private. Megjithatë, në vendimet e përditshme që merren, trafiku privat zakonisht është i pari; ndërtohen rrugë të reja, rrugët zgjerohen, planifikohet parkingu, etj. Nga planifikimi strategjik afatgjatë e deri te operimi i përditshëm, të gjitha mjetet e transportit dhe para së gjithash ato më të dobëtat në mënyrë sistematike duhet të merren parasysh njëkohësisht dhe në mënyrën më të mirë plotësuese.

**Qasja sistematike:** deri më tani, duket që ndikimi global i veprimeve lokale është nënvlerësuar në masë të madhe. Prandaj nevojitet zbatimi i një qasjeje sistematike ndaj zhvillimit të skemave për menaxhimin e trafikut.

Qasja poashtu duhet të jetë **proaktive**. Është e nevojshme, sot dhe më tepër nesër, që të synojmë qartë një qasje proaktive. Në nivel të procesit të planifikimit rrugor, kjo nënkupton që modelimi dhe projektimi pasiv i ngarkesave të ardhshme të trafikut për të përkufizuar një rrjet të ardhshëm rrugor që është në rritje të vazhdueshme me një qasje nga lart-poshtë nuk është i kënaqshëm. Në vend të kësaj, të paktën si metodë paralele, nevojitet një qasje nga poshtë-lart për të përkufizuar sasi të qëndrueshme të trafikut që mund të tolerohen në nivel lokal dhe pastaj për të organizuar qarkullimin në atë mënyrë që të respektohen këto kufizime lokale. Për ta bërë këtë, duhet të merren parasysh të gjitha mënyrat e transportit (qasja multimodale), si dhe të tregohet një nivel i caktuar kurajoje për të kontrolluar, por edhe kufizuar trafikun me automjete private në nivel lokal. Theksi duhet të vihet tek personat, jo tek automjetet, dhe përtej kësaj, është thjeshtë e rëndësishme ta kemi parasysh që një qytet nuk është veç një vend për udhëtim, por është edhe vend, bile kryesisht, për të punuar, bërë tregti, argëtuar dhe jetuar.

Këto rekomandime janë pjesë përbërëse e një procesi të vetëm dhe gjithëpërfshirës metodologjik prej katër hapash, i cili është paraqitur më poshtë në mënyrë skematike.

**Hapi 1, analiza e gjendjes ekzistuese, përshkruan gjendjen aktuale** (oferta dhe kërkesa) lidhur me mobilitetin (transporti privat, transporti aktiv, mënyrat aktive të lëvizjes,...) dhe **paraqet problemet ekzistuese** që kanë të bëjnë me mobilitetin.

**Hapi 2, objektivat dhe kufizimet, paraqet vizionin që ka autoriteti për Podujevën në aspektin e mobilitetit**, problemet kyçe të mobilitetit që duhet zgjidhur, si dhe kufizimet që duhet të merren parasysh.

**Hapi 3, koncepti i mobilitetit, thekson parimet strategjike që do të udhëheqin organizimin e mobilitetit** në Podujevë. Koncepti i zgjedhur i mobilitetit bazohet në një qasje sistematike dhe vlerësohet në raport me analizën e gjendjes aktuale (hapi 1) dhe objektivat dhe kufizimet (hapi 2).

**Hapi 4, realizimi, përshkruan masat kyçe që duhet të ndërmerren për të realizuar konceptin e mobilitetit.**

Plani i qëndrueshëm të mobilitetit urban (PQMU) karakterizohet nga: vizioni afatgjatë, gjithë përfshirja, zhvillimi i të gjitha formave të transportit, monitorimi i rregullt, vlerësimi i performances dhe kostove etj (fig.3.).



Fig.3. Karakteristikat kryesore të PQMU<sup>56</sup>

## 2 .ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE

### 2.1. Profili i komunës së Podujevës për nga perspektiva e mobilitetit

Referuar të dhënave statistikore nga Agjencia e statistikave të Kosovës, Podujeva sipas regjistrimeve të vitit 2024 ka rreth 71018 banorë (tabela 1).

Territori i komunës së Podujevës përbehet prej 78 vendbanimeve (fshatra).

Numri i banorve rezident në qytetin e Podujevës në bazë të statistikave të më hershme është (23453 banorë) që përbën rreth 27% të popullsisë së përgjithshme të komunës.

**Vërejtje:** Në mungesë të të dhënave regjistrimi të fundit të banorëve rezidentë në komunë e Podujevës janë marr numri statistikave të më hershme.

<sup>56</sup> Plani i qendrueshëm i mobilitetit urban

Tab.1. Popullsia në komunën e Podujevës

	Sipas vendbanimit të përhershëm në komunë- Lindjet / Nataliteti	Sipas vendbanimit të përhershëm në komunë Vdekjet / Mortaliteti	Sipas vendbanimit të përhershëm në komunë- Shtimi natyror	Gjithsej popullsia dhe shtimi natyror
Podujevë 31.12.2017	1.346	365	981	84.223
Prishtinë 01.01.2023 deri 30.07.2024	244	/	/	/
Marteniteti në Podujevë 01.09.2023- 01.09.2024	10	/	/	/

Vërejtje: Në mungesë të të dhënave për numrin e lindjeve dhe mortalitetit nuk kemi mundur ti paraqesim të dhënat e kompletuara në tabel.

Në mungesë të të dhënave të statistikave të fundit të popullësisë, më poshtë janë paraqitur numri i popullësisë për vendbanime nga statistikat e vjetëra.

Sipas PZHK, dendësia më e lartë e popullsisë është në qytetin e Podujevës ku mesatarisht jetojnë rreth 2635 banorë në një km<sup>2</sup>. Gjithashtu ekzistojnë edhe disa vendbanime të tjera të cilat kanë dendësi të madhe siç janë: Letanc (660 b/km<sup>2</sup>), Obrancë (529 b/km<sup>2</sup>), Surkish (500 b/km<sup>2</sup>), Lluge (444 b/km<sup>2</sup>), Gllamnik (405 b/km<sup>2</sup>) etj.

Vendbanimet me shkallë më të vogël të dendësisë së popullsisë janë: Rakinice (3 b/km<sup>2</sup>), Murgulle, Pollatë dhe Tërnavicë (4 b/km<sup>2</sup>), Metergoc (5 b/km<sup>2</sup>) etj, derisa Muhazobi, Përpellaci, Radujevci dhe Reçica nuk janë të populluara.



## 2.2. Shkalla e motorizimit

Sipas të dhënave statistikore nga viti 2020 deri në vitin 2024 në komunën e Podujevë janë të regjistruara mjete motorike dhe jo motorike, si në tab. 2.

Në Tabelën 4 janë dhënë mjetet motorike dhe jomotorike të regjistruara në Podujevë për vitet 2020 deri më 24.09.2024.

Tab.2. Automjete të regjistruara në Komunën e Podujevës

	2020	2021	2022	2023	24.09.2024
<b>Automjete</b>	11969	13333	13981	15251	12201
<b>Transportuese 3.5 dhe mbi 3.5t</b>	651	714	731	778	687
<b>Transportuese nen 3.5t</b>	1344	1630	1816	2110	1768
<b>Kombi</b>	111	112	105	97	52
<b>Autobus</b>	117	151	181	187	140
<b>Motocikleta</b>	13	19	40	40	74
<b>Traktor</b>	48	59	94	136	77
<b>Rimorkio nen 3.5t</b>	19	21	29	32	39
<b>Rimorkio 3.5 dhe mbi 3.5t</b>	143	163	178	182	179
<b>Total</b>	14405	16202	16995	18813	15217

Të dhëna nga Agjensioni civil, drejtoria e regjistrimit te automjeteve , 2020/ 24.09.2024

### 2.3. Pozita gjeografike

Komuna e Podujevës shtrihet në pjesën veriore të Kosovës, rajoni i Llapit. Komuna e Podujevës ka sipërfaqe prej: 632.97.km<sup>2</sup>.

Territori i rajonit të Llapit fillon nga Kepi i Uglarit dhe shtrihet rrjedhës së lumit Llap, i cili e lidh me Kosovën dhe me qafen e PërPELLACIT e me Nishin.




Fig.4. Pozita gjeografike e komunës se Podujevës

Komuna e Podujevës kufizohet:

- Në juglindje dhe verilindje, me Serbinë
- Në jug, me kryeqendrën e Kosovës, Prishtinën;
- Në perëndim me Mitrovicën;
- Në jug perëndim me komunat e Vushtrrisë dhe Obiliqit.
- Ne veri perëndim me komunën e Leposaviqit.

Përmes rrjetit rrugor te Podujevës mundësohet qasja ne shtetin fqinje Serbinë dhe lidhja me korridoret e rëndësishme pan evropiane. Gjithashtu rrjeti rrugor i Komunës se Podujevës, mundëson lidhje te mire me kryeqendrën e Kosovës (Prishtinën) dhe qasje me rrugët me karakter te rëndësishëm kombëtarë, autoudhet "Ibrahim Rugova" dhe "Arber Xhaferi".

## 2.4. Rrjeti rrugor në Komunën e Podujevës

Pozita strategjike Podujevës i mundëson linjë të mirë me rrjetin e rrugëve të karakterit ndërkombëtar përmes pikës kufitare në Merdare dhe gjithëashtu ofron qasje të mirë dhe lidhje të lehtë me qytetin e Prishtinës, ku sipas të dhënave të stacionit të autobusëve në Podujevë për vitin 2024 operojnë 18 operator me 86 nisje ditore.

Rrjeti rrugor i Podujevës shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 632.67 m<sup>2</sup> dhe përfshinë të gjitha kategoritë e rrugëve.

Kategorizimi i rrugëve përfshinë:

- Autoudhen,
- rrugët nacionale,
- rrugët rajonale,
- lokale,
- urbane,
- lidhëse,
- rrugët e vendbanimeve, dhe
- rrugët e pa kategorizuara.

Autoudha, rrugët nacionale dhe rrugë rajonale janë nën administrimin e Ministrisë së Infrastrukturës (MI), ndërsa nën administrimin e komunës janë rrugët lokale kryesore, rrugë lokale, urbane dhe rrugë tjera të pa kategorizuara.

Tab.3. Hierarkia e rrugëve në komunën e Podujevës

	Kategoria	Përgjegjësi
1	Autoudhë	Ministria e Infrastrukturës
2	Rrugë nacionale	Ministria e Infrastrukturës
3	Rrugë rajonale	Ministria e Infrastrukturës
4	Rrugë lokale	Komuna
5	Rrugë urbane	Komuna
6	Rrugë lidhëse	Komuna
7	Rrugët e vendbanimeve	Komuna
8	Rrugë e pa kategorizuara	Komuna

Kjo hierarki e rrugëve ka për qëllim të ndikojë që trafiku t'i gjejë vijat më të përshtatshme dhe të minimizojë ndërhyrjet nëpër zonat në të cilin kalon. Ajo shërben edhe si bazë për përcaktimin e prioriteteve të sigurisë në rrugë, mirëmbajtjes dhe menaxhimit të trafikut.

Me pëlqimin e Ministrisë dhe Komunave në të cilat në zonat urbane kalojnë rrugët nacionale dhe rajonale mund të transferohen disa aktivitete dhe përgjegjësi, siç janë:

- Mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve;
- Përgatitja e planeve për zhvillimin e rrugëve;

- Përgatitjen e planit të rindërtimit të rrugëve;
- Të përgatisë dhe zbatojë një program të masave dhe aktiviteteve për përmirësimin e sigurisë në komunikacion;
- Të mbajë të dhëna (bazën e të dhënave) e rrugëve, objekteve rrugore, shenjat e komunikacionit, dhe të menaxhojë me tokën rrugore dhe brezin mbrojtës rrugor;
- Marrin masat e nevojshme për të ruajtur dhe për të mbrojtur ambientin rreth rrugës.

Rrjeti i rrugëve të qytetit kryesisht është i ngarkuar nga kërkesat e trafikut të cilat vijnë nga zonat periferike të fshatrave të komunës. Podujeva është qendër gravitacionale për zonat periferike, ndërsa një pjesë e madhe e kërkesave për trafik të motorizuar kryesisht e përdorin rrjetin e rrugëve të Podujevës për kalim transit me destinacion qytetin e Prishtinës.

**Komuna ka një rrjet të centralizuar të rrugëve, me të gjitha rrugët e rëndësishme që të drejtojnë për në qytetin e Podujevës. Kjo strukturë i jep qytetit mundësi hyrjeje, por gjithashtu edhe probleme me trafikun e panevojshëm që kalon nëpër qendër të qytetit.**

Kërkesat me të mëdha të trafikut vijnë nga rrugët rajonale të cilat kanë qasje në pjesën qendrore të qytetit, por edhe nga rrugët tjera lokale përmes të cilave Podujeva lidhet me fshatrat për rreth. Në kuadër të rrjetit rrugor të Podujevës përfshihet rruga nacionale N25 e cila kalon në pjesën periferike të qytetit dhe nuk ka qasje direkte në zonën qendrore të qytetit.

Gjithashtu në kuadër të rrjetit rrugor të komunës së Podujevës përfshihen katër rrugë rajonale: R125, R126, R127, R128 dhe R129. Rruga rajonale R125 mundëson qasjen në zonën e kalimit kufitar Mutivodë dhe njëherit kjo rrugë lidhet me rrugën nacionale N25 përmes së cilës sigurohet qasja e disa zonave të komunës së Podujevës në qytetin e Prishtinës.

Rrugët tjera rajonale mundësojnë qasje në zonat tjera periferike të Podujevës dhe krijojnë lidhje me Komunitat: Mitrovicë dhe Vushtrri, si dhe qasje në rrjetin rrugor të Serbisë.

Tab.4. Rrjeti rrugor i komunës së Podujevës<sup>57</sup>

Kategoria	Drejtimi	Gjatësia		Sipërfaqja			Tërësitë hapësinore		
		Km	%	A	B	Total	AQ	NT	MP
Autoudha	Prishtinë – Merdare								
Rrugë Nacionale	Rruga nacionale N25	18.8	1.53	16.54	4.51	21.05	18.8	0.00	0.00
Rrugë rajonale	R129 Podujevë-Shala e Bajgorës-Mitrovicë R128 Podujevë-Lupq-Majac-Vushtrri R126 Podujevë – Pollatë-Reçicë R125 Podujevë-Orllan R127 Podujevë -Perpelac	80.0	6.53	47.44	14.20	61.67	37.29	23.12	19.59
Rrugë lokale	Rrugët lokale	370.1	30.21	166.40	63.10	229.50	181	59.1	130
Rrugë të pa kategorizu.	Rrugë lagjeve dhe fshatrave	756.30	61.73	185.48	0	185.48	370	107.8	278.5
Total		1225	100	415.86	81.84	497.70	607	190	428.1
%		100					49.55	15.51	34.94

A - sipërfaqe me asfalt dhe zhavorr – ha  
B – Sipërfaqe që shfrytëzohen për sinjalizim dhe hapësira tjera – ha

<sup>57</sup> Harta Zonale-Podujevë

### 2.4.1. Autorruga

Aktualisht rrjeti rrugor i Komunës së Podujevës përfshinë një pjesë të autoudhës R7 ("Ibrahim Rugova"), e cila planifikohet të vazhdojë deri në Merdarë (fig.5.).




Fig.5. Pjesë e trasesë së autorrugëve "Ibrahim Rugova" dhe "Arber Xhaferi"

Auto rruga R7 e cila planifikohet të vazhdojë deri në pikën kufitare në Merdarë, u shërben kërkesave nga territori i komunës së Podujevës lidhjen me pjesën tjetër të rrugëve të Kosovës me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar. Aktualisht autoudha R7 është funksionale dhe e finalizuar deri në fshatin Trudë, ndërsa pjesa tjetër në gjatësi prej rreth 27 km (Trudë-Merdarë) është në proces të projektimit dhe finalizimit. Përmes kësaj rruge mundësohet lidhje me korridoret pan evropiane (korridorin e XIII dhe X). Gjithashtu përmes autoudhës "Ibrahim Rugova" edhe territorit të Podujevës i mundësohet lidhja e qytetit të Prishtinës dhe zonave tjera të Kosovës me rrjetin rrugor të Serbisë përmes të cilit mandej mundësohet qasja në rrjetin ndërkombëtar të rrugëve të Evropës perëndimore.

Parametrat teknik të këtyre rrugëve i plotësojnë standardet e projektimit dhe ndërtimit dhe ofrojnë kushte të favorshme për qarkullim të lirë të automjeteve dhe të sigurt.

#### 2.4.2. Rrugët nacionale dhe rajonale

Komuna e Podujevës është pjese rrjetit të rrugëve me karakter dhe rendësi nacionale. Pjese e këtij rrjeti është rruga nacionale N25 përmes së cilës Podujeva lidhet me kryeqendrën e Kosovës, Prishtinën dhe pjesën kufitare me Serbinë. Pra, lidhja me kryeqendrën dhe piken kufitare në Merdare, mundësohet përmes rrugës nacionale N25.

Rruga nacionale N25 për nga funksioni konsiderohet rrugë shumë e rëndësishme, sepse kërkesat për qarkullim dhe lidhje me kryeqytetin nga banoret e Podujevës dhe zonave për rreth janë mjaft të mëdha.

Kjo rrugë N25 kalon në zonën periferike të qytetit të Podujevës dhe ofron dalje po ashtu në Serbi. Përmes

Rruga nacionale shtrihen në zonën aktive zhvillimore dhe paraqet arterie të rëndësishme të zhvillimit të komunës, përgjatë të cilës janë zhvilluar edhe vendbanimet kryesore të komunës, përfshirë këtu edhe zonën urbane.

Parametrat teknik të rrugëve nacionale në përgjithësi i plotësojnë kriteret e projektimit dhe në aspektin infrastrukturor ofrojnë kushte të mira për qarkullim të mjeteve motorike. Në hyrje të qytetit në këto rrugë, viteve të fundit janë realizuar punime të rehabilitimit dhe rikonstruimit me qëllim të përmirësimit të kushteve të qarkullimit dhe ofrimit të qasjes me të lehtë për pjesëmarrësit në trafik.

Rruga nacionale N25 Prishtinë – Merdar është në fazën e përfundimtare të zgjerimit nga dy në katër shirita të komunikacionit, me nga dy shirita komunikacionit për secilën kahe të lëvizjes. Në këtë segment nevojitet të rritet cilësia mirëmbajtjes së rrugës, rregullimi i anësoreve dhe trotuareve në zonat ku ka kërkesa për lëvizje të pa motorizuara, të plotësohet sinjalizimi dhe të vendose sipas standardeve, kufizimi i aktiviteteve ekonomike përgjatë segmenteve rrugore sipas standardeve dhe rregullimi i qasjeve në rrugën kryesore duke plotësuar kushtet e sigurisë etj.

Në pjesët ku kryqëzohen rrugët e rangut më të ulët në rrugën nacionale N25, si forma të kontrollit të trafikut janë zgjedhur kryqëzimet me rrethrotullim në nivel, disnivel dhe kryqëzimet e formës klasike në nivel. Në këto nyje në të kaluarën janë paraqitë probleme në aspektin e sigurisë.

Parametrat teknik të rrugëve nacionale me nga dy shirita të komunikacionit për kahje dhe me ndarje fizike (ishull) në përgjithësi i plotësojnë kriteret e projektimit dhe në aspektin infrastrukturor ofrojnë siguri më të lartë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion.

### 2.4.3. Rrugët Rajonale

Rrjeti i rrugëve të Podujevës po ashtu përfshinë rrugën rajonale R125, R126, R127, R128 dhe R129. Rruga rajonale R125 mundëson qasjen në zonën e kalimit kufitar Mutivodë dhe lidhjen me rrugën nacionale N25 përmes se cilës sigurohet qasja e disa zonave të komunës së Podujevës në qytetin e Prishtinës.

Referuar PZHK të Podujevës, gjatësia e rrugëve rajonale në kuadër të rrjetit rrugor të komunës së Podujevës është rreth 80 km.

Tabela.5. Rrjeti i rrugëve rajonale në komunën e Podujevës

	Rrugët rajonale	Gjatësia [km]
1	R125 (Lluzhan - Batllavë – Orllan –deri në kufirin me Serbinë)	25.3
2	R126 (Batllav-Podujevë – Pollatë - Reçicë)	28.1
3	R127 (Llapashticë e Poshtme - Podujevë – Perpelac)	14.6
4	R128 (Podujevë – Llapashticë e Epërme)	3.3
5	R129 (Bajçinë – deri në kufirin e KK të Mitrovicës)	7.7

Përmes rrugës rajonale R126 vendbanimet periferike të Komunës së Podujevës (në linjën Batllave-Peran) lidhen me rrjetin e rrugëve urbane të qytetit të Podujevës dhe sigurojnë qasje në rrugën nacionale N25. Rruga rajonale R129 siguron lidhjen e qytetit me zonën periferike të vendbanimeve dhe siguron qasje në rrjetin rrugor të komunës së Mitrovicës.

Përgjithësisht rrugët rajonale ofrojnë kushte të mira për qarkullim të automjeteve motorike, të gjitha janë të asfaltuara, por kanë nevojë për mirëmbajtje, riabilitim dhe përmirësim të sipërfaqes qarkulluese me qëllim të përmirësimit të kualitetit të lëvizjes dhe rritjes së nivelit të sigurisë gjatë lëvizjes. Plotësimi i kërkesave për lëvizje të pa motorizuara në këto pjesë të rrjetit rrugor po ashtu kërkon trajtim dhe masa konkrete.

Sipas planit zhvillimor komunal, numri total i vendbanimeve që kanë qasje në rrugët nacionale dhe rajonale është 38 që nënkupton se rreth 48.7% e tyre kanë qasje direkte, ndërsa 51.3 % e vendbanimeve nuk kanë qasje direkte në rrugët nacionale dhe rajonale.




Fig.6. Rugët nacionale dhe rajonale

#### 2.4.4. Rugët lokale (urbane)

Rrugët lokale ku përfshihen edhe rrugët urbane, kryesisht janë dy shiritore (me nga një shirit qarkullues për kahe), përveç një pjese të rrugëve të qytetit të cilat kanë nga një shirit qarkullues për kahe.

Rrugët urbane brenda qytetit kryesisht në aspektin e funksionalitetit ofrojnë qasje të mirë për mjetet motorike, shtigje për biçikleta, si dhe me hapsira të dedikuara (tretuare) për personat e verbër dhe këmbësorët. Shumica e rrugëve janë projektuar dhe ndërtuar në harmoni me kriteret teknike të projektimit dhe ndërtimit. Rrugët urbane kryesisht janë të sinjalizuara me sinjalizime përkatëse rrugore.



Tabela.6. Gjatësia e kategorive të rrugëve, të asfaltuara dhe të pa asfaltuara në komunën e Podujevës

Kategoritë e rrugëve	Gjatësia [km]	Gjendja e rrugës		Kushtet e qarkullimit
		Asfaltuar [km]	Pa asfaltuar [km]	
Rr. Nacionale	18.8	18.8	0	Mesatarisht te favorshme
Rr. Rajonale	80	80	0	Mesatarisht te favorshme
Rr. Lokale Rr. të pa kategorizuara	1047.9551	1047.9551	Nuk ka informacion	Te mira

Emri dhe gjatësia e secilës rrugë dhe përmbledhja e llojeve dhe gjatësive respektive në komunën e Podujevës, të marra nga zyrtari në drejtorin e urbanizmit, gjithsej gjatësia e segmenteve rrugore (m): 1.146,751.11 m ose 1,146.75111 km. Për rrugë të pa asfaltuara nuk kemi informacion me gjatësi të rrugëve.




Fig.7. Rrjeti i rrugëve urbane të qytetit të Podujevës

Ne vitet e fundit Komuna e Podujevës ka bërë investime të mira në përmirësimin e rrugëve në qytet, fshatra duke investuar në asfaltimin, ndertimin e disa rrugëve të reja dhe përmirësimin e qarkullimit të lëvizjes së pjesëmarrësve në komunikacion.

## 2.5. Gjendja e udhëkryqeve

Ne baze të analizave të bëra në disa nga udhëkryqet në komunën e Podujevës kemi ngulfatje, kjo diktohet me shumë në periudha të ndryshme kohore brenda vitit siq janë; jolinearitetet në periudhën e muajve sezonale dhe jo sezonale e cila rezultojnë në rritjen dhe ngjitjen e nivelit të shërbimit si:

- Niveli i shërbimit në periudhën sezonale ku e kemi ngarkesën më të madhe (qarkullim i ngopur) varjon në muajt: Dhjetor – Janar, Qershor – Korrik – Gusht. Në këta muaj niveli i shërbimit për dalje nga udhëkryqet rezultojnë me humbje kohore më shumë se 45 sec/auto., që i takon nivelit të shërbimit "F", si në tab.7.
- Niveli i shërbimit në periudhën jo sezonale në disa udhëkryqe është më i mirë se që i takon NSH. "C", përveç kohëve të pikut ku ngarkesa e automjeteve në udhëkryqe rritet si pasojë e orareve të punetoreve dhe nxënëseve që frekuentojnë.

Në aspektin funksional të kryqëzimeve është shumë e rëndësishme përzgjedhja e tipit adekuat të kryqëzimit. Varësisht nga kërkesa e trafikut, cila prej zgjidhjeve do të plotësonte kushtet e pranueshme të nivelit të shërbimit dhe kapacitetit do të jetë zgjidhja e cila duhet të merret në konsiderim.

Kryqëzimet e rrugëve të Podujevës janë kryesisht në të njëjtin nivel dhe për nga forma i përkasin kryqëzimeve të formës klasike (+, T) dhe rrethrotullimeve, ndërsa kohën e fundit janë aplikuar si forma të kontrollit të trafikut edhe kryqëzimi me sinjalizim ndriçues.

Tabela.7. Niveli i shërbimit në udhëkryq për humbje mesatare kohore sec/aut

Niveli i Shërbimit	Humbjet mesatare kohore (sec/aut)
A	≤ 5
B	>5 dhe ≤ 10
C	>10 dhe ≤ 20
D	> 20 dhe ≤ 30
E	> 30 dhe ≤ 45
F	> 45




Fig.8. Udhëkryqet kryesore në rrjetin rrugor të Podujevës

## 2.6. Transporti publik

Ne komunën e Podujevës organizohet transporti në linjat: urbano – periferike, urbano – periferike në vendbanimet rurale, ndërsa transporti urban ne qytet ende nuk është funksional, edhe pse që janë përcaktuar linjat.

Zhvillimi i transportit urbane, urbano – periferike, urbano – periferike në vendbanimet rurale, është bazuar në Ligjin për transportin rrugor dhe të rregullores për organizimin e transportit brenda Komunës së Podujevës Nr. Prot. 01-345/01-0008883/23 të datës 31.01.2023.

Transporti urbano-periferik organizohet ne linjat urbano-periferike nga disa kompani private te licencuara brenda komunës, me linja të ndara që i shërbejnë rreth 78 vendbanimeve. Funksionaliteti i operimit ne këto linja mundësohet nga rreth 45 autobusëve dhe kombi-busëve, 30 taksive dhe radio-taksive.




Fig.9. Rrjeti i transportit publik<sup>58</sup>

Në nivel rajonal transporti publik organizohet nga Ministria e Infrastrukturës (MI) dhe lidhë qytetin e Podujevës me kryeqytetin (nga komuna e Podujevës ka kërkesa te shumta qe te gravitojnë ne kryeqendër-Prishtine) .

Për pjesëmarrje në jetën shoqërore dhe ekonomike mund të thuhet se mobiliteti është kushti kryesorë për të gjithë njerëzit. Ky mobilitet duhet të planifikohet në atë mënyrë që të minimizojë ndikimet negative në ambient në njërin anë, ndërsa nga ana tjetër duhet ta rrisë qasshmërinë e qytetarëve në destinacione të dëshiruara duke ndikuar pozitivisht edhe në sigurinë në trafik dhe kualitetin e jetës.

<sup>58</sup> [Public transport Victoria- travelling-on-the-network/accessibility](#)

## 2.7. Parkingjet

### - Parkim dhe Zgjidhje për Menaxhimin e Hapësirave Publike

**Parkim i menaxhuar mirë:** Zhvillimi i parkimeve të organizuara dhe përdorimi i teknologjisë për të drejtuar automjetet drejt vendeve të lira për parkim. Kjo zvogëlon kohën e harxhuar në kërkim të parkimit dhe shmang bllokimet.

**Park & Ride:** Krijimi i hapësirave të parkimit jashtë qendrave urbane ku qytetarët mund të parkojnë automjetet e tyre dhe të përdorin transportin publik për të hyrë në qytet.

Në Podujevë parkingjet janë të organizuara dhe menaxhohen nga Ndërmarrja Publike Lokale- NPL "Eko Llapi" Sh.a. Bazuar në të dhënat nga KK i Podujevës, hapësirat që shfrytëzohen për parkingje në Komunën e Podujevës janë dhënë në tabelën.8.

Tab.8. Parkingjet publike në komunën e Podujevës

Parkingjet publike	
Lokacioni – Vendndodhja	Nr. i vend parkingjeve
Rruga "Zahir Pajaziti"(Parkingu-I-prapa banesave, pranë Lumit Llap)	77
Rruga "Zahir Pajaziti" (Parkingu-II-prapa banesave, pranë Lumit Llap)	35
Rruga "Ilir Konushevci" (Përballë stacionit Policor)	70
Rruga "Nuhi Gashi" (Përballë komunës së Podujevës)	15
Ruga "Bahri Fazliu" (Mbrapa komunës)	23
Ruga "Afrim Zhitia" (në mes shkollave fillore "N.F dhe Sh.Sh")	20
<b>Totali</b>	<b>240</b>

Tab.9. Parkingjet private në komunën e Podujevës

Parkingjet private	
Lokacioni – Vendndodhja	Nr. i vend parkingjeve
Rruga "Zahir Pajaziti" (Parkingu pranë Caffè Bar "Pranvera")	120
Rruga "Zahir Pajaziti" (Parkingu në objektin e Malësisë)	90
Rruga "Zahir Pajaziti" (Parkingu te Qendra Tregtare "Blaku")	22
Rruga "Zahir Pajaziti" (Parkingu perballe SHME "Isa Boletini")	75
Rruga "Nuhi Gashi" (Parkingu te Sabiti)	20
Rruga "Nuhi Gashi" (Parkingu te Kaqanollët)	15
Rruga "Nuhi Gashi" (Parkingu afer UniverTrade djathtas)	20
Rruga "Nuhi Gashi" (Parkingu afer UniverTrade majtas)	13
Rruga "Xhemajl Mustafa" (Parkingu afer Market Egzonita)	21
Rruga "Xhemajl Mustafa" (Parkingu te Dushkollët)	24
Rruga "Brigadat" (Parkingu 1 pranë Bashkësisë Islame)	17
Rruga "Brigadat" (Parkingu 2 pranë Bashkësisë Islame)	14
Rruga kah Xhamia (Parkingu 1 pranë qerdhes)	20
Rruga kah Xhamia (Parkingu 2 pranë qerdhes)	20
<b>Totali</b>	<b>491</b>

Bazuar në të dhënat e mësipërme, oferta e parkingjeve në qytetin e Podujevës është rreth 240 vend parkingje publike, 491 vend parkingje private . Pra, oferta e përgjithshme e parkingjeve publike është rreth 731 vend parkingje.

Me ndërtimin e parkingut nëntokësor i cili është planifikuar në sheshin "Ali Ajeti", do të plotësohen kërkesat e qytetarve për parkime të mjaftueshme të automjeteve.

Vend parkingjet e super marketeve, marketeve, dyqaneve afariste etj., në qytetin e Podujevës janë me kapacitet shumë të madha në adaptimin e automjeteve për qëndrim, të cilat e rrisin numrin e vendeve për parking në total dhe i përmirësojnë nevojat e qytetarëve.

Referuar numrit të automjeteve të regjistruara në komunën e Podujevës si dhe kërkesave për parkingje në zonat urbane, janë të mjaftueshme lokacionet me vende për parkime të automjeteve.

## 2.8. Rrjeti hekurudhor

Rrjeti hekurudhor që kalon nëpër territorin urban të Podujevës ka shtrirje veri-jug, përkatësisht i takon kategorisë së komunikacionit nacional e cila e lidhë Podujevën me Prishtinën, por njëkohësisht ka edhe karakter internacional. Segmenti që kalon nëpër zonën urbane të Podujevës është me gjatësi 4.9 km dhe zë sipërfaqen prej 2.9 ha. Sigurisht se shtrirja e rrjetit hekurudhor ka rëndësi shumë të madhe për zonën urbane, sepse ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin socio-ekonomik të saj.

Karakteristike e veçantë e rrjetit të transportit në komunën e Podujevës është zhvillimi i transportit hekurudhor. Edhe pse aktualisht linja hekurudhore nuk është funksionale, me planin strategjik kombëtar është planifikuar rehabilitimi dhe funksionalizimi i kësaj linje.

Kjo linjë kalon në pjesën qendrore të komunës së Podujevës, është një binarësh me gjatësi prej 22 km. Funksionalizimi i kësaj linje dhe shtrirja e rrjetit hekurudhor në nivel nacional ka një rëndësi shumë të madhe për komunën, si në aspektin e zhvillimit të transportit, po ashtu përmes kësaj linje mundësohet lidhja me qytetin e Prishtinës dhe Fushe Kosovës, përmes së cilës lidhen edhe me qendrat tjera të cilat përfshihen në rrjetin hekurudhor. Kjo linjë gjithashtu mundëson qasje në rrjetin hekurudhor të Serbisë (fig.10.).



Fig.10. Qasje e rrjetit hekurudhorë të Kosovës (nëpërmjet Podujevës) në rrjetin hekurudhor të Serbisë

Linja hekurudhore e cila kalon në territorin e Komunës së Podujevës është e rëndësishme veçanësisht, sepse përmes saj mund të sigurohet qasje në korridoret evropiane, siç është korridori 10 (linja e cila përfshinë territorin e Serbisë, nga pjesa kufitare me Hungarinë deri në pjesën kufitare me Maqedoninë e veriut dhe vazhdon lidhjen me Greqinë dhe Bullgarinë).




Fig.11. Lidhja e rrjetit hekurudhor të Kosovës me rrjetin hekurudhor ndërkombëtar (korridorin 10)

Ne kuadër të objektivave operacionale të përfshira në “Strategjinë Sektoriale dhe Transporti Multimodal” (Objektiva 1- Integrimi në korridoret pan evropiane), parashihet funksionalizimi e linjës hekurudhore e cila kalon në territorin e komunës së Podujevës<sup>59</sup>:

- Lidhja e propozuar e sistemit të transportit multimodal me rrjetet e rëndësishme TMM të BE-së, nëpërmjet vendosjes së bashkëpunimit me subjektet lokale, rajonale, ndërkombëtare, me aleancat strategjike dhe me kompanitë simotra. **Linja hekurudhore 10 dhe Rruga R6 dhe R7 seksioni i mbetur Besi-Merdare, sigurojnë, në të ardhmen, rrugë alternative për korridoret hekurudhore X dhe VIII.**
- Zbatimi progresiv i rekomandimeve nga studimi i parafizibilitetit për Linjën 10 hekurudhore, që kjo rrugë të kthehet në gjendje të mirë operacionale.

Po ashtu në kuadër të qëllimeve të përcaktuara me HZ të Kosovës përfshihet rehabilitimi/funksionalizimi i linjës hekurudhore lindje-perëndim (Podujevë-F.Kosovë-Pejë-Prizren)<sup>60</sup>.

<sup>59</sup> Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025

<sup>60</sup> Harta zonale e Kosovës 2020 – 2028+




## 2.9. Siguria në trafik

Kjo analizë ofron të dhëna analitike për nivelin e sigurisë së trafikut rrugor në regjionin e Podujevës. Të dhënat janë paraqitur për vitin 2018 dhe për qëllim krahasimi janë përdorur të dhënat nga viti 2017. Gjatë vitit 2018 në regjionin e Podujevës ka ndodhur gjithsej 1256 aksidente trafiku, të ndara sipas pasojave.


Tabela 10. Krahasimi i të dhënave të aksidenteve për periudhën Janar-Dhjetor 2017-2018 në regjionin e Podujevës

Aksidente me dëme materiale pa lëndime për vitet 2017-2018 dhe 2019 në podujevë			
	Viti 2017	Viti 2018	Deri 18.11.2019
Z.Urbane	118	92	94
Z.Rurale	83	52	42
	201	145	136

Diag.1. Paraqitja grafike me përqindje e aksidenteve me dëme materiale për vitet 2017,2018 dhe 2019 në zonën urbane të territorit të komunës së Podujevës




Diag.2. Paraqitja grafike me përqindje e aksidenteve me dëme materiale për vitet 2017,2018 dhe 2019 në zonat rurale të territorit të komunës së Podujevës



Të dhënat e aksidenteve tregojnë për rritje të numrit të aksidenteve nga viti 2018 në 2019 për rreth 1% në zonat urbane, ndërsa është shënuar rënie për rreth 5% në zonat rurale. Në krahasim me vitin 2017, në dy vitet e fundit 2018/19 është shënuar rënie e lehtë e numrit të aksidenteve me dëme materiale.

“...Mbetet të plotësohet me të dhëna të aksidenteve sipas lokacioneve të ndryshme në kuadër të territorit të komunës së Podujevës, sipas llojit dhe pasojave (me lëndime trupore apo me fatalitet) të aksidenteve, mandej do të bëhet vlerësimi i masave të nevojshme apo të domosdoshme në pjesët e ndryshme të rrugëve në kuadër të rrjetit rrugor të Podujevës...”.

Diag.3. Të dhënat e aksidenteve me lëndime trupore për vitet 2017,2018 dhe 2019 në territorin e komunës së Podujevës (të plotësohen dhe modifikohen paraqitjet grafike në varësi nga rezultatet e matjeve”)



Të dhënat e aksidenteve me fatalitet për vitet 2017,2018 dhe 2019 në territorin e komunës së Podujevës  
 Vërejtje: Me datën 17.09.2024 përmes email adresë ju kemi drejtuar stacionit policor në Podujevë me kërkesë për të dhënat e aksidenteve për vitet 2020 – 2024, e që akoma nuk janë përgjigjur!

## 2.10. Ngarkesa e trafikut

“Mbetet të plotësohet ....(të dhënat lidhur me kërkesën për trafik të motorizuar dhe të pa motorizuar kanë mbetur në proces të plotësimit nga grupi punues..., të plotësohen dhe modifikohen tabela 11. e më poshtme në varësi nga rezultatet e matjeve”.

Tab.11. Të dhënat lidhur me kërkesën për trafik të motorizuar dhe të pa motorizuar T




Tabela 12. Ndryshimi i qarkullimit të automjeteve në rrugët kryesore të Podujevës nga viti 2020-2024

Vitet	Qarkullimi	N25 Prishtine - Podujeve	R125 (Lluzhan- kufiri me Serbinë)	R126(Batllavë Podujevë )	R128(Podujevë- Llapashticë e Epërme)	R129 (Bajçinë – Mitrovicës)
	Njësia	aut/vit	aut/vit	aut/vit	aut/vit	aut/vit
2020	TMDV	-	-	-	-	-
2021	TMDV	-	-	-	-	-
2022	TMDV	-	-	-	-	-
2023	TMDV	-	-	-	-	-
2024	TMDV	-	-	-	-	-
Rritja mesatare	(%)	-	-	-	-	-
Rritja e përgj. mesatare	%	%	%	%	%	%

Ndërsa, ndryshimet sezonale të fluksit të automjeteve në Komunën e podujevas, janë dhënë në Tabelën 13.

Tabela 13. Ndryshimet e qarkullimit të automjeteve në rrugët kryesore të Podujevës përgjatë muajve te vitit

	N25 Prishtine - Podujeve	R125 (Lluzhan-kufiri me Serbinë)	R126(Batllavë Podujevë )	R128(Podujevë- Llapashticë e Epërme)	R129 (Bajçinë – Mitrovicës)
Muaji	-	-	-	-	-
Janar	-	-	-	-	-
Shkurt	-	-	-	-	-
Mars	-	-	-	-	-
Prill	-	-	-	-	-
Maj	-	-	-	-	-
Qershor	-	-	-	-	-
Korrik	-	-	-	-	-
Gusht	-	-	-	-	-
Shtator	-	-	-	-	-
Tetor	-	-	-	-	-
Nëntor	-	-	-	-	-
Dhjetor	-	-	-	-	-
Gjithsej	-	-	-	-	-
TMDV	-	-	-	-	-

	N25 Prishtine - Podujeve	R125 (Lluzhan- kufiri me Serbinë)	R126(Batllavë Podujevë )	R128(Podujevë– Llapashticë e Epërme)	R129 (Bajçinë – Mitrovicës)
24:00-01:00	-	-	-	-	-
01:00-02:00	-	-	-	-	-
02:00-03:00	-	-	-	-	-
03:00-04:00	-	-	-	-	-
03:00-04:00	-	-	-	-	-
04:00-05:00	-	-	-	-	-
05:00-06:00	-	-	-	-	-
06:00-07:00	-	-	-	-	-
07:00-08:00	-	-	-	-	-
08:00-09:00	-	-	-	-	-
09:00-10:00	-	-	-	-	-
10:00-11:00	-	-	-	-	-
11:00-12:00	-	-	-	-	-
12:00-13:00	-	-	-	-	-
13:00-14:00	-	-	-	-	-
14:00-15:00	-	-	-	-	-
15:00-16:00	-	-	-	-	-
16:00-17:00	-	-	-	-	-
17:00-18:00	-	-	-	-	-
18:00-19:00	-	-	-	-	-
19:00-20:00	-	-	-	-	-
21:00-22:00	-	-	-	-	-
22:00-23:00	-	-	-	-	-
23:00-24:00	-	-	-	-	-
Gjithsej	-	-	-	-	-

Ndërsa, ndryshimi i qarkullimit në orë brenda ditës (24 orëve), Tabela 14.

*Tabela 14. Ndryshimi i qarkullimit në orë brenda ditës në rrugët kryesore të Podujevës*

Në tabelat e paraqitura më lartë nr. 12, 13 dhe 14, ku duhet të plotësohen me të dhënat e TMDV e të cilat nuk kemi mundur ti marrim për arsye se në rrugët nacionale N25 dhe rajinale R125, R126, R128 dhe R129 nuk posedojnë detektor të numrimit të automjeteve.

## 2.11. Analiza e ngarkesës së kryqëzimeve

Të dhënat e matjeve nga flukset e trafikut të motorizuar në kryqëzimet e zonës urbane të Podujevës, të mbledhura në intervale të ndryshme kohore brenda ditës dhe në ditët e ndryshme brenda javës, janë paraqitur në vijim (Tab.15., Tab...., Tab ).

Tab.15. Të dhënat e matjeve nga flukset e trafikut të motorizuar në kryqëzimet

Të dhënat e matjeve të flukseve të trafikut në kryqëzime -Podujevë					
Kategorizimi					N.SH.
Ora	8 <sup>00</sup> : 9 <sup>00</sup>				
<b>Udhëkryqi te Pranvera 99 Forma "T"</b>					
Drejtimet	Drej. Emergjen.	Drej. Sheshit	Drej. Lumi		
Numri	128 [auto/h]	352 [auto/h]	344 [auto/h]		NSH- (C)
<b>Udhëkryqi te Spitali Forma "+"</b>					
Drejtimet	Drej. I emergjences	Drej. I pranvera 99	Drej. IAAP ekonomi	Drej. Barnatoreve	
Numri	145 [auto/h]	164 [auto/h]	152 [auto/h]	66 [auto/h]	NSH-(B)
<b>Udhëkryqi te shkolla Ekonomike Forma "T"</b>					
Drejtimet	Drej. I sheshit	Drej. Interex	Drej. udhekryqit		
Numri	236 [auto/h]	316 [auto/h]	168 [auto/h]		NSH-(C)
<b>Udhëkryqi te Zena Forma "+"</b>					
Drejtimet	Nga Zena drejtimi i pishave	Nga Ilmi Maqani drejtimi Ekonomi	Nga Pishat drej. Te Zena	Nga Ekonomia drej. Ilmi maqani	
Numri	92 [auto/h]	126 [auto/h]	58 [auto/h]	128 [auto/h]	NSH-(B)
<b>Udhëkryqi te Intereksi Forma "+"</b>					
Drejtimet	Nga sheshi ne drejtim te rrethit	Nga rrethi drejtimi i ekonomise	Ne rrugen "Vllezerit Frasherit"	Ne rruegen "Besnik Restelica	
Numri	360 [auto/h]	220[auto/h]	128 [auto/h]	148 [auto/h]	NSH (C)
<b>Udhëkryqi te Kutlesht Forma "T"</b>					
Drejtimet	Drejtimi "Ilmi Maqani"	Drej. I dyqanit te "Luta"	Rruga "Besnik Restelica"	/	
Numri	132 [auto/h]	140 [auto/h]	135 [auto/h]	/	NSH (B)

<b>Rrethërrrotullimi te rruga për Kërpimeh</b>					
<b>Drejtimit</b>	Rruga nga Lumi Llap drej. I rrethit	Ura e Fushalive drej. I rrethit	Nga Kerpimehi ne drej. Te rrethit	Shkolla "Ibrahim Rugova " drejtimi i rrethit	
<b>Numri</b>	184 [auto/h]	152 [auto/h]	168 [auto/h]	198 [auto/h]	NSH (B)
<b>Udhëkryqi te Egzonita e vjetër Forma "T"</b>					
<b>Drejtimit</b>	Ne drejtim te shkolles "Fan s. Noli"	Ne drejtim te ures se fushalive	Nga stacioni i policise ne drejtim te taxi dumnice		
<b>Numri</b>	168 [auto/h]	172 [auto/h]	155 [auto/h]		NSH (B)
<b>Udhëkryqi te Policia Forma "T"</b>					
<b>Drejtimit</b>	Taxat e dumnces drej. I stacionit policor	Ne drejtim te sheshit			
<b>Numri</b>	76 [auto/h]	141 [auto/h]	/	/	NSH (B)
<b>Udhëkryqi te Gjykata Forma "T"</b>					
<b>Drejtimit</b>	Nga Shf. "Shaban Shala" drej. kimi	Nga stacioni Policor ne drej. gjykates			
<b>Numri</b>	102 [auto/h]	122 [auto/h]	/	/	NSH (B)
<b>Rrethërrrotullimi te kafja e Majacve</b>					
<b>Drejtimit</b>	Nga shaban shala drej. kafja e majacve	Nga stacioni i policis te rrethi	Nga rrethi ne drejtim te kafes se majacve		
<b>Numri</b>	140 [auto/h]	168 [auto/h]	145 [auto/h]	/	NSH (B)
<b>Udhëkryqi te Shkolla "Shaban Shala" Forma "+"</b>					
<b>Drejtimit</b>	Nga QKMF ne drejtim te udhekryqi	Kafja e majacve drej. I udhekryqit	Nga gjykata drej. udhekryq	Nga shkolla "Naim Frasher" drej. Udhekryqit	
	145 [auto/h]	163 [auto/h]	154 [auto/h]	138 [auto/h]	NSH (B)

<b>Ora</b>	<b>12<sup>00</sup> : 13<sup>00</sup></b>				
<b>Udhëkryqi te Pranvera 99 Forma "T"</b>					
<b>Drejtmet</b>	Drej. Emergjenc.	Drej. Sheshit	Drej. Lumi		
<b>Numri</b>	198 [auto/h]	304 [auto/h]	308 [auto/h]		NSH- (C)
<b>Udhëkryqi te Spitali Forma "+"</b>					
<b>Drejtmet</b>	Drej. I emergjences	Drej. I pranvera 99	Drej. IAAP ekonomi	Drej. Barnatoreve	
<b>Numri</b>	508 [auto/h]	120 [auto/h]	152 [auto/h]	576 [auto/h]	NSH(F)
<b>Udhëkryqi te shkolla Ekonomike Forma "T"</b>					
<b>Drejtmet</b>	Drej. I sheshit	Drej. Interex	Drej. udhekryqit		
<b>Numri</b>	544 [auto/h]	600 [auto/h]	120 [auto/h]		NSH – (C)
<b>Udhëkryqi te Zena Forma "+"</b>					
<b>Drejtmet</b>	Nga Zena drejtimi i pishave	Nga Ilmi Maqani drejtimi Ekonomi	Nga Pishat drej. Te Zena	Nga Ekonomia drej. Ilmi maqani	
<b>Numri</b>	122 [auto/h]	300 [auto/h]	36 [auto/h]	188 [auto/h]	NSH (C)
<b>Udhëkryqi te Intereksi Forma "+"</b>					
<b>Drejtmet</b>	Nga sheshi ne drejtim te rrethit	Nga rrethi drejtimi i ekonomise	Ne rrugen "Vllezerit Frasherit"	Ne rruegen "Besnik Restelica	
<b>Numri</b>	366 [auto/h]	728 [auto/h]	152 [auto/h]	288 [auto/h]	NSH (F)
<b>Udhëkryqi te Kutlesht Forma "T"</b>					
<b>Drejtmet</b>	Drejtimi "Ilmi Maqani"	Drej. I dyqanit te "Luta"	Rruga "Besnik Restelica"	/	
<b>Numri</b>	722 [auto/h]	404 [auto/h]	150 [auto/h]	/	NSH (C)
<b>Rrethërotullimi te rruga për Kërpimeh</b>					
<b>Drejtmet</b>	Rruga nga Lumi Llap drej. I rrethit	Ura e Fushalive drej. I rrethit	Nga Kerpimehi ne drej. Te rrethit	Shkolla "Ibrahim Rugova " drejtimi i rrethit	
<b>Numri</b>	804 [auto/h]	352 [auto/h]	768 [auto/h]	798 [auto/h]	NSH (F)
<b>Udhëkryqi te Egzonita e vjetër Forma "T"</b>					
<b>Drejtmet</b>	Ne drejtim te shkolles "Fan s. Noli"	Ne drejtim te ures se fushalive	Nga stacioni i policise ne drejtim te taxi dumnice		
<b>Numri</b>	342 [auto/h]	222 [auto/h]	355 [auto/h]		NSH (C)
<b>Udhëkryqi te Policia Forma "T"</b>					
<b>Drejtmet</b>	Taxat e dumnices drej. I stacionit policor	Ne drejtim te sheshit			
<b>Numri</b>	260 [auto/h]	340 [auto/h]	/	/	NSH (C)












Udhëkryqi te Gjykata Forma "T"					
Drejtimit	Nga Shf. "Shaban Shala" drej. kimi	Snga stacioni Policor ne drej. gjykates			
Numri	192 [auto/h]	134 [auto/h]	/	/	NSH (B)
Rrethërrrotullimi te kafja e Majacve					
Drejtimit	Nga shaban shala drej. kafja e majacve	Nga stacioni i policis te rrethi	Nga rrethi ne drejtim te kafes se majacve		
Numri	640 [auto/h]	268 [auto/h]	458 [auto/h]	/	NSH (C)
Udhëkryqi te Shkolla "Shaban Shala" Forma "+"					
Drejtimit	Nga QKMF ne drejtim te udhekryqit	Kafja e majacve drej. udhekryqit	Nga gjykata drej. udhekryq	Nga shkolla "Naim Frasherit" drej. udhekryqit	
Numri	404 [auto/h]	143 [auto/h]	165 [auto/h]	104 [auto/h]	NSH (C)
Ora	16 <sup>00</sup> : 17 <sup>00</sup>				
Udhëkryqi te Pranvera 99 Forma "T"					
Drejtimit	Drej. Emergjens.	Drej. Sheshit	Drej. Lumi		
Numri	223 [auto/h]	314 [auto/h]	287 [auto/h]		NSH- (C)
Udhëkryqi te Spitali Forma "+"					
Drejtimit	Drej. I emergjences	Drej. I pranvera 99	Drej. IAAP ekonom	Drej. Barnatoreve	
Numri	355 [auto/h]	178 [auto/h]	252 [auto/h]	276 [auto/h]	NSH-(F)
Udhëkryqi te shkolla Ekonomike Forma "T"					
Drejtimit	Drej. I sheshit	Drej. Interex	Drej. udhekryqit		
Numri	584 [auto/h]	623 [auto/h]	324 [auto/h]		NSH-(C)
Udhëkryqi te Zena Forma "+"					
Drejtimit	Nga Zena drejtimi i pishave	Nga Ilmi Maqani drejtimi Ekonomi	Nga Pishat drej. Te Zena	Nga Ekonomia drej. Ilmi maqani	
Numri	322 [auto/h]	334 [auto/h]	136 [auto/h]	288 [auto/h]	NSH (C)
Udhëkryqi te Intereksi Forma "+"					
Drejtimit	Nga sheshi ne drejtim te rrethit	Nga rrethi drejtimi i ekonomise	Ne rrugen "Vllezerit Frasherit"	Ne rruegen "Besnik Restelica	
Numri	566 [auto/h]	788 [auto/h]	252 [auto/h]	298 [auto/h]	NSH (F)



Udhëkryqi te Kutlesht Forma "T"					
Drejtmet	Drejtimi "Ilmi Maqani"	Drej. I dyqanit te "Luta"	Rruga "Besnik Restelica"	/	
Numri	234 [auto/h]	269 [auto/h]	189 [auto/h]	/	NSH (B)
Rrethërotullimi te rruga për Kërpimeh					
Drejtmet	Rruga nga Lumi Llap drej. I rrethit	Ura e Fushalive drej. I rrethit	Nga Kerpimehi ne drej. Te rrethit	Shkolla "Ibrahim Rugova" drejtimi i rrethit	
Numri	206 [auto/h]	289 [auto/h]	368 [auto/h]	498 [auto/h]	NSH (C)
Udhëkryqi te Egzonita e vjetër Forma "T"					
Drejtmet	Ne drejtim te shkolles "Fan s. Noll"	Ne drejtim te ures se fushalive	Nga stacioni i policise ne drejtim te taxi dumnice		
Numri	280 [auto/h]	260 [auto/h]	285 [auto/h]		NSH (C)
Udhëkryqi te Policia Forma "T"					
Drejtmet	Taxat e dumnces drej. I stacionit policor	Ne drejtim te sheshit			
Numri	301 [auto/h]	243 [auto/h]	/	/	NSH (C)
Udhëkryqi te Gjykata Forma "T"					
Drejtmet	Nga Shf. "Shaban Shala" drej. kimi	Snga stacioni Policor ne drej. gjykates			
Numri	142 [auto/h]	167 [auto/h]	/	/	NSH (B)
Rrethërotullimi te kafja e Majacve					
Drejtmet	Nga shaban shala drej. kafja e majacve	Nga stacioni i policis te rrethi	Nga rrethi ne drejtim te kafes se majacve		
Numri	630 [auto/h]	368 [auto/h]	449 [auto/h]	/	NSH (C)
Udhëkryqi te Shkolla "Shaban Shala" Forma "+"					
Drejtmet	Nga QKMF ne drejtim te udhekryqit	Kafja e majacve drej. udhekryqit	Nga gjykata drej. udhekryq	Nga shkolla "Naim Frasheri" drej. udhekryqit	
Numri	324 [auto/h]	343 [auto/h]	265 [auto/h]	204 [auto/h]	NSH (C)

Të dhënat e matjeve e kërkesave për lëvizje te pa motorizuara ne kryqëzimet ne zonën urbane te Podujevës janë paraqitur me tabelat vijuese Tab.16.,Tab.17., Tab.18., Tab.19.

Tab.16.Të dhënat e matjeve te kërkesave për lëvizje te pa motorizuara ne kryqëzimet ... Podujeve

Të dhënat e matjeve te kërkesave për lëvizje te pa motorizuara ne kryqëzime												
												
Ora	08 <sup>00</sup> :09 <sup>00</sup>						08 <sup>00</sup> :09 <sup>00</sup>					
Drejtimit												
Hyrja I	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Hyrja II	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Hyrja III	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Hyrja IV	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
